UDHËZUES PËR KRIJIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E HAPËSIRAVE TË SIGURTA PËR TË RINJTË NË SHQIPËRI

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels
(EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)

Funded by the European Union

TETOR 2026

SHKURTIMET

Udhëzues - "Udhëzuesi për krijimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave të sigurta për të rinjtë në Shqipëri";

NjVV - Njësitë e vetëqeverisjes vendore;

BE - Bashkimi Evropian;

Strategjia e BE për Rininë - Strategjia e BE për Rininë 2019–2027;

KE - Këshilli i Evropës;

SKR 2022-2029 - Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022–2029.

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels
(EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)
Funded by the European Union

Përmbajtja

I. HYRJE 5

I.1. Qëllimi i udhëzuesit 6

I.2. Objektivat specifikë 6

I.3. Grupi i synuar dhe përdoruesit e udhëzuesit 7

I.4. Fusha e zbatimit 7

I.5. Lidhja me legjislacionin ekzistues të funksionimit të hapësirave për të rinjtë në Shqipëri 8

I.6. Si të përdoret udhëzuesi 9

II. KUADRI LIGJOR DHE POLITIKAT EVROPIANE DHE KOMBËTARE 10

II.1. Kuadri i Bashkimit Evropian për hapësirat e sigurta për të rinjtë 10

II.2. Standardet dhe dokumentet e Këshillit të Evropës për hapësirat e sigurta për të rinjtë 11

II.3. Ndërthurja e kuadrit ligjor për hapësirat e sigurta me legjislacionin për të drejtat dhe mbrojtjen 12

II.4. Legjislacioni dhe kuadri strategjik shqiptar për hapësirat e sigurta për të rinjtë 13

II.4.1. Legjislacioni për rininë dhe koncepti i hapësirës së sigurt 14

II.4.2. Ndërthurja e legjislacionit shqiptar për hapësirat e sigurta me atë të të drejtave dhe mbrojtjes 14

III. KONCEPTI, PARIMET DHE DIMENSIONET E HAPËSIRËS SË SIGURT PËR TË RINJTË 15

III.1. Koncepti i hapësirës së sigurt për të rinjtë 15

III.2. Parimet themelore dhe dimensionet e sigurisë 18

IV. KRIJIMI I HAPËSIRAVE TË SIGURTA PËR TË RINJTË NË SHQIPËRI 23

IV.1. Siguria e hapësirës dhe përgjegjësia institucionale 23

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels
(EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)

Funded by the European Union

IV.1.1. Nga hapësira ekzistuese drejt një hapësire të sigurt 28

IV.1.2. Hapësirë e re për të rinjtë dhe projektimi i sigurisë 32

V. GARANTIMI I HAPËSIRAVE TË SIGURTA PËR TË RINJTË - NJË PROCES INSTITUCIONAL I VAZHDUESHËM 35

V.1. Procesi institucional i garantimit të hapësirave të sigurta për të rinjtë 35

VI. REKOMANDIME PËR ZBATIM 40

MEKANIZMAT PRAKTIKË TË ZBATIMIT TË UDHËZUESIT 43

ANEKS NR. 1 "MATRICA E VETËVLERËSIMIT TË PARIMEVE TË HAPËSIRËS SË SIGURT PËR TË RINJTË" 45

ANEKSI NR. 2 "MATRICA E VETËVLERËSIMIT TË DIMENSIONEVE TË SIGURISË NË HAPËSIRËN E SIGURT PËR TË RINJTË" 48

ANEKSI NR. 3 "MATRICA PËR ZBATIMIN E PROCESIT TË KRIJIMIT DHE MENAXHIMIT TË NJË HAPËSIRE TË SIGURT PËR TË RINJTË" 54

ANEKSI NR. 4 "LISTA E KONTROLLIT PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E NJË HAPËSIRE TË SIGURT PËR TË RINJTË" 57

ANEKSI NR. 5 "MJETET PËR PJESËMARRJEN DHE MARRJEN E MENDIMEVE TË TË RINJVE" 61

ANEKSI NR. 6 "PLAN VEPRIMI PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E NJË HAPËSIRE TË SIGURT PËR TË RINJTË" 64

ANEKSI NR. 7 "MODEL ORIENTUES I RREGULLAVE TË HAPËSIRËS" 66

ANEKSI NR. 8 "TABELË ORIENTUESE PËR STAFIN DHE PERSONAT PËRGJEGJËS PËR NJË HAPËSIRË TË SIGURT PËR TË RINJTË" 68

REFERENCAT LIGJORE DHE BIBLIOGRAFIA 71

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels
(EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)

Funded by the European Union

I. HYRJE

Hapësirat ku të rinjtë mblidhen, marrin shërbime, zhvillojnë aktivitete, mësojnë, bashkëpunojnë dhe shprehin pikëpamjet e tyre kanë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e tyre personal, social dhe qytetar. Për këtë arsye, krijimi i hapësirave të sigurta, gjithëpërfshirëse dhe miqësore për të rinjtë është një element i rëndësishëm i punës me të rinjtë dhe i ofrimit të shërbimeve dhe aktiviteteve rinore.

Një hapësirë e sigurt për të rinjtë nuk nënkupton vetëm një ambient fizik të mirëmbajtur dhe të pajisur me kushte minimale sigurie. Ajo lidhet edhe me mënyrën se si të rinjtë trajtohen dhe respektohen, me mundësinë për të marrë pjesë pa diskriminim, me mbrojtjen nga dhuna, abuzimi, ngacmimi dhe shfrytëzimi, me respektimin e privatësisë dhe të të dhënave personale, si dhe me ekzistencën e mekanizmave të qartë për të kërkuar ndihmë, për të raportuar shqetësime dhe për të marrë mbështetjen e nevojshme.

Për këtë arsye, siguria e hapësirave për të rinjtë duhet të konsiderohet si një proces i vazhdueshëm që përfshin parandalimin, identifikimin e rreziqeve, reagimin ndaj shqetësimeve, referimin te shërbimet kompetente, pjesëmarrjen e të rinjve dhe përmirësimin e vazhdueshëm.

"Udhëzuesi për krijimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave të sigurta për të rinjtë në Shqipëri" (Udhëzues) është hartuar për të ofruar orientime praktike për institucionet shtetërore qendrore, njësitë e vetëqeverisjes vendore (NjVV), qendrat dhe hapësirat rinore, organizatat dhe profesionistët që punojnë me të rinjtë, me qëllim mbështetjen e krijimit dhe mirëmbajtjes së mjediseve ku të rinjtë mund të marrin pjesë, të shprehen dhe të zhvillojnë aktivitete në kushte sigurie, respekti dhe dinjiteti. Udhëzuesi synon të orientojë institucionet dhe aktorët përgjegjës në Shqipëri për mënyrën se si mund të krijojnë ose përshtatin hapësira ekzistuese për t'i bërë ato më të sigurta për të rinjtë.

Udhëzuesi trajton parimet dhe dimensionet kryesore të sigurisë së hapësirave rinore dhe ofron orientime për identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve, masat parandaluese, përgjegjësitë e stafit

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels
(EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)
Funded by the European Union

dhe të personave të angazhuar, mekanizmat e raportimit dhe referimit, përgatitjen për situata emergjente, pjesëmarrjen e të rinjve dhe monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm.

I.1. Qëllimi i udhëzuesit

Qëllimi i këtij Udhëzuesi është të ofrojë një kuadër praktik për krijimin, organizimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave të sigurta për të rinjtë në Shqipëri. Udhëzuesi synon të ndihmojë institucionet dhe ofruesit e shërbimeve rinore që siguria të trajtohet në mënyrë sistematike dhe të integrohet në funksionimin e përditshëm të hapësirës rinore. Siguria trajtohet si një koncept shumëdimensional që përfshin:

- sigurinë fizike dhe përshtatshmërinë e ambienteve;
- sigurinë psikologjike dhe emocionale;
- mbrojtjen nga dhuna, abuzimi, ngacmimi dhe shfrytëzimi;
- parandalimin e diskriminimit dhe përjashtimit;
- aksesueshmërinë dhe përfshirjen;
- respektimin e privatësisë dhe mbrojtjen e të dhënave personale;
- sigurinë në mjedisin digjital dhe gjatë aktiviteteve jashtë hapësirës së zakonshme;
- përgatitjen dhe reagimin ndaj situatave emergjente;
- pjesëmarrjen e të rinjve në përcaktimin dhe vlerësimin e kushteve të sigurisë.

I.2. Objektivat specifikë

Objektivi i përgjithshëm i këtij udhëzuesi është të ofrojë një kuadër praktik për krijimin, organizimin, funksionimin dhe përmirësimin e hapësirave të sigurta, gjithëpërfshirëse dhe miqësore për të rinjtë, duke mbështetur parandalimin dhe menaxhimin e rreziqeve, mbrojtjen e të drejtave dhe mirëqenies së të rinjve dhe pjesëmarrjen e tyre aktive në ndërtimin e një mjedisi të sigurt.

Objektivat specifikë të tij janë të:

- qartësojë konceptin dhe dimensionet e një hapësire të sigurt për të rinjtë, duke përfshirë sigurinë fizike, psikologjike, sociale dhe digjitale, si dhe parimet e respektimit të të drejtave, dinjitetit, barazisë dhe mosdiskriminimit.
- orientojë identifikimin, vlerësimin dhe parandalimin e rreziqeve që mund të ndikojnë në sigurinë, mirëqenien dhe pjesëmarrjen e të rinjve në hapësirat dhe aktivitetet rinore.
- përcaktojë masa dhe praktika për krijimin dhe mirëmbajtjen e mjediseve të sigurta dhe të aksesueshme, duke konsideruar karakteristikat e hapësirës, aktivitetet e zhvilluara dhe nevojat e ndryshme të të rinjve.
- qartësojë rolet dhe përgjegjësitë e personave të angazhuar në funksionimin e hapësirave rinore, përfshirë drejtuesit, stafin, punonjësit rinorë, vullnetarët dhe personat e tjerë përgjegjës për ofrimin e aktiviteteve dhe shërbimeve.

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels
(EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)
Funded by the European Union

- forcojë mekanizmat e mbrojtjes, raportimit, reagimit dhe referimit, duke ofruar orientime për trajtimin fillestar të shqetësimeve dhe incidenteve dhe për lidhjen me strukturat dhe shërbimet kompetente.
- promovojë mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave personale dhe përdorimin e sigurt të teknologjisë dhe mjediseve digjitale, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- forcojë pjesëmarrjen dhe përfshirjen e të rinjve në krijimin dhe përmirësimin e hapësirave të sigurta, duke i përfshirë në identifikimin e rreziqeve, përcaktimin e rregullave, marrjen e mendimeve dhe vlerësimin e kushteve të sigurisë.
- ofrojë instrumente praktike për vetëvlerësimin, monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sigurisë, duke përfshirë lista kontrolli, modele për vlerësimin e rrezikut dhe mjete për mbledhjen e perceptimeve dhe mendimeve të të rinjve.

I.3. Grupi i synuar dhe përdoruesit e udhëzuesit

Udhëzuesi u drejtohet aktorëve që kanë përgjegjësi, rol ose interes në krijimin, organizimin dhe funksionimin e hapësirave të sigurta për të rinjtë, si:

- institucionet qendrore përgjegjëse për politikat dhe programet rinore;
- NjVV dhe strukturat përgjegjëse për rininë dhe shërbimet sociale;
- qendrat rinore dhe hapësirat multifunksionale rinore;
- organizatat rinore dhe ato të shoqërisë civile;
- punonjësit rinorë, koordinatorët dhe drejtuesit e hapësirave rinore;
- vullnetarët dhe personeli tjetër i angazhuar në aktivitete me të rinjtë;
- ofruesit e shërbimeve publike, sociale, shëndetësore dhe komunitare që bashkëpunojnë me strukturat rinore;
- profesionistë dhe ekspertë që mbështesin zhvillimin dhe funksionimin e hapësirave rinore;
- partnerët dhe organizatat ndërkombëtare që mbështesin programe dhe iniciativa për të rinjtë.

Në mënyrë të tërthortë, Udhëzuesi u shërben edhe vetë të rinjve. Informimi i tyre për të drejtat, rregullat e sjelljes, mënyrat e kërkimit të ndihmës dhe mekanizmat e raportimit është një element i rëndësishëm i krijimit të një hapësire të sigurt.

I.4. Fusha e zbatimit

Udhëzuesi mund të përdoret në hapësira të ndryshme ku të rinjtë zhvillojnë aktivitete, marrin shërbime, marrin pjesë në procese konsultimi, organizohen ose ndërveprojnë me profesionistë dhe me njëri-tjetrin.

Ai mund të zbatohet, ndër të tjera, në: qendra rinore publike dhe multifunksionale; hapësira rinore pranë NjVV; hapësira komunitare që ofrojnë aktivitete ose shërbime për të rinjtë; ambiente të përdorura ose të administruara nga organizata rinore dhe organizata të shoqërisë civile; hapësira të

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels
(EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)
Funded by the European Union

përkohshme të krijuara për aktivitete rinore; aktivitete rinore të zhvilluara jashtë ambienteve të përhershme; aktivitete dhe shërbime që zhvillohen pjesërisht ose tërësisht në mjedise digjitale; hapësirat e institucioneve arsimore që përdoren për aktivitete, programe, iniciativa ose shërbime për të rinjtë;

Fusha e zbatimit përfshin si aspektet fizike të hapësirës, ashtu edhe mënyrën e organizimit dhe ofrimit të aktiviteteve dhe shërbimeve rinore. Për këtë arsye, krijimi i hapësirave të sigurta për të rinjtë kërkon vëmendje ndaj ambienteve, marrëdhënieve ndërpersonale, procedurave, komunikimit dhe mekanizmave të reagimit.

Udhëzuesi mund të përdoret në faza të ndryshme:

- Para hapjes ose krijimit të hapësirës, për identifikimin e rreziqeve dhe planifikimin e masave të nevojshme.
- Gjatë funksionimit të hapësirës, për zbatimin e masave parandaluese, monitorimin e sigurisë dhe trajtimin e shqetësimeve.
- Gjatë ndryshimit ose riorganizimit të hapësirës, për rivlerësimin e rreziqeve dhe përshtatjen e masave.
- Pas një incidenti ose shqetësimi, për të vlerësuar reagimin e ndërmarrë dhe për të përcaktuar masa që mund të parandalojnë përsëritjen.

Udhëzuesi nuk kërkon të zëvendësojë detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi, rregulloret institucionale, kërkesat teknike apo procedurat profesionale të strukturave kompetente. Në rastet që kërkojnë ndërhyrje të specializuar, strukturat rinore përgjegjëse duhet të ndjekin procedurat përkatëse dhe të realizojnë referimin te autoritetet ose shërbimet kompetente.

I.5. Lidhja me legjislacionin ekzistues të funksionimit të hapësirave për të rinjtë në Shqipëri

Krijimi i hapësirave të sigurta për të rinjtë duhet të shihet si pjesë e një qasjeje më të gjerë për zhvillimin dhe funksionimin cilësor të shërbimeve dhe strukturave rinore në Shqipëri.

Siguria nuk qëndron e shkëputur nga elementet e tjera të funksionimit të një hapësire. Ajo lidhet me mënyrën se si: planifikohen aktivitetet, organizohet stafi përgjegjës, ofrohen shërbimet, garantohet aksesueshmëria, përfshihen të rinjtë dhe si monitorohet cilësia e ndërhyrjeve.

Udhëzuesi duhet të lexohet në harmoni me legjislacionin në fuqi për rininë, mbrojtjen dhe të drejtat e njeriut, barazinë dhe mosdiskriminimin, aksesueshmërinë, mbrojtjen e të dhënave personale dhe fushat e tjera që lidhen me sigurinë dhe mirëqenien e të rinjve. Njëkohësisht, ai ofron një këndvështrim të veçantë mbi sigurinë e hapësirave për të rinjtë, duke e përkthyer kuadrin e përgjithshëm në masa dhe mjete që mund të përdoren në praktikën e përditshme.

Përdorimi i Udhëzuesit nuk duhet të kuptohet si një proces thjesht formal. Qëllimi është që parimet e sigurisë të integrohen në mënyrën se si hapësira për të rinjtë planifikohet, administrohet dhe

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels
(EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)
Funded by the European Union

përdoret. Për këtë arsye, një hapësirë e sigurt për të rinjtë kërkon kombinimin e: mjedisit të përshtatshëm; rregullave të qarta; stafit të përgatitur; mekanizmave të mbrojtjes; pjesëmarrjes së të rinjve; monitorimit të vazhdueshëm.

I.6. Si të përdoret udhëzuesi

Udhëzuesi është hartuar si një instrument praktik dhe mund të përdoret në mënyrë të plotë ose sipas nevojave specifike të një hapësire për të rinjtë. Ai është hartuar që krijimi apo përmirësimi i hapësirave të sigurta për të rinjtë të realizohet përmes një procesi të vazhdueshëm, i cili përfshin disa etapa:

- **Identifiko** - Identifikohen karakteristikat e hapësirës, aktivitetet që zhvillohen, grupet e përdoruesve dhe rreziqet e mundshme.
- **Vlerëso** - Rreziqet e identifikuara vlerësohen sipas mundësisë së ndodhjes dhe ndikimit të tyre. Vlerësimi duhet të përfshijë edhe situatat e të rinjve që mund të përballen me një rreziku të caktuar.
- **Planifiko** - Përcaktohen masat parandaluese dhe korrigjuese, përgjegjësit, afatet dhe burimet e nevojshme.
- **Zbato** - Masat e planifikuara integrohen në funksionimin e përditshëm të hapësirës, duke përfshirë rregullat e brendshme, kodin e sjelljes, informimin e të rinjve, trajnimin e stafit dhe procedurat e raportimit dhe referimit.
- **Monitoro** - Kushtet dhe praktikat e sigurisë monitorohen në mënyrë periodike përmes listave të kontrollit, rivlerësimit të rreziqeve, marrjes së mendimeve të të rinjve dhe përdorimit të instrumenteve të tjera të përshtatshme.
- **Përmirëso** - Gjetjet e monitorimit dhe përvojat e përdoruesve përdoren për të identifikuar boshllëqet dhe për të përcaktuar masa konkrete për përmirësim.

Për ta bërë përdorimin e Udhëzuesit sa më praktik janë përfshirë edhe mekanizmat e zbatimit të tij, që mund të përshtaten sipas nevojave të strukturës përkatëse. Ato synojnë të ndihmojnë strukturat përgjegjëse të kuptojnë më mirë rreziqet, të identifikojnë boshllëqet dhe të marrin masa konkrete për garantimin e hapësirave të sigurta për të rinjtë.

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels
(EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)
Funded by the European Union

II. KUADRI LIGJOR DHE POLITIKAT EVROPIANE DHE KOMBËTARE

Koncepti i hapësirave të sigurta për të rinjtë mbështetet në një kuadër të ndërthurur aktesh ligjore dhe dokumentesh strategjike e politike. Ky kuadër përfshin dispozita që lidhen me rininë dhe hapësirat rinore, si dhe kërkesa më të gjera në fushën e të drejtave të njeriut, mbrojtjes nga dhuna, barazisë dhe mosdiskriminimit, aksesueshmërisë, mbrojtjes së fëmijëve, privatësisë, mbrojtjes së të dhënave personale dhe sigurisë në mjedisin digjital.

Për këtë arsye, krijimi dhe funksionimi i një hapësire të sigurt për të rinjtë kërkon një qasje të integruar dhe ndërsektoriale. Kërkesat që zbatohen në çdo rast varen nga kuadri ligjor në fuqi, mosha e përdoruesve, natyra e hapësirës, aktivitetet e zhvilluara dhe mënyra e ofrimit të shërbimeve.

II.1. Kuadri i Bashkimit Evropian për hapësirat e sigurta për të rinjtë

Kuadri politik i Bashkimit Evropian (BE) për hapësirat e sigurta për të rinjtë mbështetet veçanërisht në Strategjinë e BE për Rininë 2019–2027[1] (Strategjia e BE për Rininë) dhe 11 Objektivat Rinore Evropiane[2], specifikisht në Objektivin Rinor Evropian nr. 9 – "Hapësira dhe pjesëmarrja për të gjithë"[3].

[1] EU Youth Strategy
[2] Youth Goals
[3] 9 Space and Participation for All

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels
(EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)
Funded by the European Union

Strategjia e BE e vendos pjesëmarrjen, përfshirjen dhe fuqizimin e të rinjve në qendër të bashkëpunimit evropian në fushën e rinisë. Në këtë kuadër, hapësirat për të rinjtë kanë rëndësi për zhvillimin personal, social, kulturor dhe qytetar të të rinjve dhe për krijimin e mundësive për pjesëmarrje aktive.

Objektivi Rinor Evropian nr. 9, "Hapësira dhe pjesëmarrja për të gjithë", thekson rëndësinë e hapësirave fizike të hapura, të sigurta dhe të aksesueshme, të cilat mundësojnë pjesëmarrjen e të rinjve dhe mbështeten nga kapacitete profesionale të përshtatshme. Kjo qasje është e rëndësishme edhe për mjediset virtuale, ku siguria, aksesueshmëria dhe përfshirja duhet të jenë elemente kryesore gjatë organizimit të aktiviteteve dhe ndërveprimit me të rinjtë.

E njëjta qasje shtrihet edhe në hapësirat virtuale, të cilat duhet të jenë të aksesueshme dhe të sigurta për të rinjtë. Siguria nuk kufizohet vetëm në kushtet fizike të një mjedisi. Ajo lidhet edhe me mbrojtjen nga dhuna, abuzimi, diskriminimi dhe ngacmimi, respektimin e privatësisë, aksesueshmërinë, përfshirjen, mirëqenien dhe sigurinë psikologjike, si dhe sigurinë në mjedisin digjital.

Krahas kuadrit politik për rininë, Karta e të Drejtave Themelore të BE përmban dispozita me rëndësi për respektimin e dinjitetit njerëzor, integritetit të personit, jetës private, mbrojtjen e të dhënave personale, barazinë dhe mosdiskriminimin. Në veçanti, nenet 21, 24 dhe 26 trajtojnë përkatësisht mosdiskriminimin, të drejtat e fëmijës dhe integrimin e personave me aftësi të kufizuara.

Një element i rëndësishëm i kësaj qasjeje është edhe pjesëmarrja e të rinjve. Të rinjtë nuk konsiderohen vetëm përdorues të hapësirës, por edhe pjesëmarrës që mund të kontribuojnë në identifikimin e nevojave, përcaktimin e rregullave, organizimin e aktiviteteve dhe përmirësimin e mjedisit ku marrin pjesë. Nga dokumentet dhe instrumentet e mësipërme përcaktohen disa orientime kryesore për krijimin dhe funksionimin e hapësirave të sigurta për të rinjtë:

- Siguria dhe mbrojtja – parandalimi dhe adresimi i rreziqeve që mund të cenojnë të rinjtë;
- Aksesueshmëria dhe përfshirja – mundësi të barabarta për përdorim dhe pjesëmarrje;
- Mosdiskriminimi dhe respekti – respektimi i dinjitetit dhe diversitetit;
- Pjesëmarrja – përfshirja aktive e të rinjve në zhvillimin dhe përmirësimin e hapësirës;
- Mbështetja profesionale – kapacitetet njerëzore dhe mekanizmat e përshtatshëm të mbështetjes;
- Siguria digjitale dhe privatësia – mbrojtja e të rinjve edhe në ndërveprimet e shërbimet online.

II.2. Standardet dhe dokumentet e Këshillit të Evropës për hapësirat e sigurta për të rinjtë

Këshilli i Evropës (KE) ka zhvilluar një kuadër standardesh, rekomandimesh dhe instrumentesh që lidhen me të drejtat e njeriut, pjesëmarrjen e të rinjve, punën rinore, barazinë, përfshirjen sociale

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels
(EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)

Funded by the European Union

dhe mbrojtjen nga diskriminimi e dhuna. Këto instrumente ofrojnë orientime të rëndësishme për trajtimin e sigurisë së të rinjve në lidhje me të drejtat, dinjitetin, pjesëmarrjen dhe aksesin në mundësi e shërbime. Ndër dokumentet me rëndësi për temën e këtij Udhëzuesi përfshihen:

- **Rekomandimi CM/Rec(2017)4[4] mbi punën rinore** - e koncepton punën rinore si një fushë aktivitetesh sociale, kulturore, edukative, mjedisore dhe politike, të zhvilluara nga, me dhe për të rinjtë, mbi bazën e pjesëmarrjes vullnetare dhe të të nxënit formal dhe informal. Për hapësirat rinore, ai nënvizon rëndësinë e punës rinore të orientuar te të rinjtë, pjesëmarrjes aktive, përfshirjes sociale dhe stafit të përgatitur.
- **Rekomandimi CM/Rec(2016)7[5] mbi aksesin e të rinjve në të drejtat e tyre** - synon të përmirësojë njohjen dhe ushtrimin e të drejtave nga të rinjtë, si dhe heqjen e pengesave ligjore, politike dhe sociale. Në kontekstin e hapësirave të sigurta, kjo lidhet me informimin e të rinjve për të drejtat e tyre, mundësinë për të kërkuar ndihmë, mekanizmat e ankesave dhe referimit dhe mbrojtjen nga diskriminimi.
- **Rekomandimi CM/Rec(2015)3[6] mbi aksesin e të rinjve nga zonat me akses të kufizuar në të drejtat sociale** - e lidh përfshirjen e të rinjve me aksesin në shërbime, pjesëmarrjen, mosdiskriminimin, parandalimin e dhunës dhe përfshirjen sociale.

Gjithashtu, Udhëzimet e KE[7] për integrimin dhe përfshirjen e barazisë gjinore në aktivitetet rinore ofrojnë orientime praktike për krijimin e mjediseve gjithëpërfshirëse, duke përfshirë masa kundër diskriminimit dhe ngacmimit dhe mekanizma për raportimin e shqetësimeve.

Në tërësi, standardet dhe rekomandimet e KE ofrojnë orientime për zhvillimin e hapësirave rinore që respektojnë të drejtat dhe dinjitetin e të rinjve, nxisin pjesëmarrjen kuptimplotë, mbështesin përfshirjen dhe mosdiskriminimin dhe kontribuojnë në parandalimin e dhunës e të ngacmimit. Ato evidentojnë gjithashtu rëndësinë e stafit të përgatitur dhe të mekanizmave të përshtatshëm për trajtimin e shqetësimeve dhe referimin e rasteve.

II.3. Ndërthurja e kuadrit ligjor për hapësirat e sigurta me legjislacionin për të drejtat dhe mbrojtjen

Kuadri për krijimin dhe funksionimin e hapësirave të sigurta për të rinjtë duhet të analizohet në lidhje me aktet ligjore dhe instrumentet e tjera që rregullojnë fusha të veçanta. Për këtë arsye, vlerësimi i sigurisë nuk duhet të kufizohet në kushtet fizike të ambientit, por duhet të përfshijë edhe detyrimet e zbatueshme nga legjislacioni në fushat përkatëse:

[4] Recommendation CM/Rec(2017)4 of the Committee of Ministers to member States on youth work;
[5] Recommendation CM/Rec(2016)7 of the CM on young people's access.
[6] Recommendation CM/Rec(2015)3 of the CM on the access of young people to social rights;
[7] Gender mainstreaming.

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels
(EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)
Funded by the European Union

- **Mbrojtja nga dhuna, abuzimi, shfrytëzimi, neglizhenca dhe ngacmimi** - është një komponent themelor i sigurisë. Në këtë drejtim, një referencë e rëndësishme është Konventa e KE[8] për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi Seksual (Konventa e Lanzarotës[9]), e cila kërkon masa për parandalimin e dhunës seksuale, mbrojtjen e viktimave fëmijë dhe ndjekjen e autorëve.
- **Strategjia e KE për të Drejtat e Fëmijës 2022–2027[10] -** përcakton fusha veprimi që lidhen me mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna, përfshirjen, shëndetin dhe mirëqenien, si dhe të drejtat e tyre në mjedisin digjital. Kur hapësirat rinore përdoren nga persona nën moshën 18 vjeç, këto orientime duhet të merren parasysh së bashku me legjislacionin kombëtar për mbrojtjen e fëmijëve dhe procedurat përkatëse.
- **Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara[11] -** përcakton parime dhe detyrime që lidhen me mosdiskriminimin, aksesueshmërinë dhe pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara. Në kontekstin e hapësirave rinore, aksesueshmëria duhet të merret parasysh jo vetëm në mjedisin fizik, por edhe në informacion, komunikim dhe organizimin e aktiviteteve.
- **Rregullorja e BE 2016/679 për mbrojtjen e të dhënave personale[12] -** përbën një referencë të rëndësishme evropiane në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. Hapësirat rinore mund të mbledhin dhe përpunojnë të dhëna të pjesëmarrësve, si të dhënat e kontaktit, listat e pjesëmarrjes, fotografitë, videot dhe informacione të tjera të lidhura me aktivitetet. Për hapësirat që veprojnë në Shqipëri, përpunimi i këtyre të dhënave duhet të shqyrtohet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe, kur plotësohen kushtet përkatëse, me kërkesat e zbatueshme të së drejtës së BE-së.

II.4. Legjislacioni dhe kuadri strategjik shqiptar për hapësirat e sigurta për të rinjtë

Edhe në Shqipëri, koncepti i hapësirave të sigurta për të rinjtë duhet të kuptohet brenda një legjislacioni të ndërthurur, ku legjislacioni për rininë krijon bazën specifike për politikat dhe strukturat rinore, ndërsa kërkesat për sigurinë, aksesueshmërinë, mbrojtjen dhe përfshirjen plotësohen nga legjislacioni në fusha të tjera.

Ligji nr. 75/2019, "Për rininë" (i ndryshuar) përbën bazën kryesore ligjore për organizimin dhe zhvillimin e politikave rinore. Megjithatë, krijimi i një hapësire të sigurt për të rinjtë nuk është vetëm çështje e legjislacionit për rininë. Sipas natyrës së hapësirës dhe përdoruesve të saj, zbatohen njëkohësisht kërkesa që lidhen me planifikimin dhe sigurinë e mjedisit fizik, aksesueshmërinë dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara, mbrojtjen e fëmijëve, barazinë dhe

[8] Convention;
[9] Shqipëria e ka ratifikuar Konventën, më 1 korrik 2010;
[10] Strategy for the Rights of the Child (2022-2027);
[11] Convention on the Rights of Persons with Disabilities.
[12] Regulation (EU) 2016/679 of the European Parliament and of the Council.

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels
(EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)
Funded by the European Union

mosdiskriminimin, mbrojtjen nga dhuna, privatësinë dhe të dhënat personale, si dhe sigurinë digjitale.

II.4.1. Legjislacioni për rininë dhe koncepti i hapësirës së sigurt

Ligji nr. 75/2019, "Për rininë" (i ndryshuar) përcakton se qendra rinore është person juridik që ofron infrastrukturën rinore për zhvillimin e aktiviteteve dhe veprimtarive rinore, programeve të edukimit joformal, aktiviteteve të informimit, mentorimit dhe trajnimit të të rinjve dhe punës rinore. Në këtë aspekt, është e rëndësishme të bëhet një dallim ndërmjet dy koncepteve:

- hapësira e sigurt për të rinjtë i referohet një mjedisi fizik, social, psikologjik ose digjital që krijon kushte për siguri, mbrojtje, akses, përfshirje dhe pjesëmarrje;
- qendra rinore i referohet një strukture të organizuar, të përcaktuar nga legjislacioni për rininë, që ofron infrastrukturë dhe aktivitete, programe dhe shërbime të dedikuara për të rinjtë.

Për rrjedhojë, një qendër rinore mund të jetë një hapësirë e sigurt, por koncepti i hapësirës së sigurt është më i gjerë se koncepti i qendrës rinore. Hapësira të sigurta mund të krijohen dhe të përdoren edhe në mjedise të tjera ku zhvillohen aktivitete, programe ose shërbime për të rinjtë, sipas natyrës dhe qëllimit të tyre.

Legjislacioni për rininë e lidh zhvillimin e strukturave dhe shërbimeve rinore edhe me kërkesa që burojnë nga fusha të tjera. Në këtë drejtim qëndron dhe Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022–2029 (SKR 2022-2029), që përbën dokumentin strategjik kryesor kombëtar për zhvillimin e politikave rinore. SKR 2022-2029 e lidh hapësirën e sigurt për të rinjtë me disa elemente themelore si mirëqenia fizike, sociale dhe mendore e të rinjve, siguria, mbrojtja, përfshirja, pjesëmarrja dhe ofrimi i shërbimeve miqësore dhe të pranueshme për të rinjtë.

II.4.2. Ndërthurja e legjislacionit shqiptar për hapësirat e sigurta me atë të të drejtave dhe mbrojtjes

- **Planifikimi dhe përdorimi i territorit** - hapësira rinore e sigurt në Shqipëri duhet të plotësojë jo vetëm kërkesat që lidhen me funksionin e saj rinor, por edhe kërkesat që lidhen me planifikimin dhe përdorimin e territorit, ndërtimin, kushtet teknike, sigurinë e objektit dhe mbrojtjen në raste emergjencash, sipas natyrës së ndërtesës dhe veprimtarisë që zhvillohet në të. Për këtë arsye, në planifikimin, përshtatjen ose rikonstruksionin e një hapësire rinore duhet të analizohet legjislacioni dhe aktet nënligjore përkatëse në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, kërkesat teknike të zbatueshme, si dhe rregullat për mbrojtjen nga zjarri, emergjencat dhe sigurinë e përdoruesve.
- **Përfshirja dhe aksesueshmëria -** Siguria e një hapësire nuk mund të konsiderohet e plotë nëse një pjesë e të rinjve nuk mund ta aksesojë ose përdorë atë në mënyrë të barabartë. Në këtë drejtim, rëndësi të veçantë ka legjislacioni për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels
(EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)
Funded by the European Union

personave me aftësi të kufizuara. Aksesueshmëria duhet të konsiderohet në mënyrë të integruar dhe të përfshijë mjedisin fizik, informacionin dhe komunikimin, si dhe mënyrën e organizimit të aktiviteteve dhe shërbimeve. Një hapësirë rinore nuk është plotësisht e sigurt nëse pengesat fizike, të komunikimit ose organizative pengojnë pjesëmarrjen e një grupi të caktuar të rinjsh.

- **Mbrojtja e fëmijëve, barazia dhe mbrojtja nga dhuna -** Kur hapësirat rinore përdoren nga persona nën moshën 18 vjeç, krahas legjislacionit për rininë zbatohen edhe kërkesat e legjislacionit për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, për mbrojtjen nga dhuna, abuzimi, shfrytëzimi dhe neglizhimit, për barazinë dhe mosdiskriminimin, si dhe legjislacionin përkatës për barazinë gjinore. Këto fusha përcaktojnë pjesë të ndryshme të asaj që në praktikë e bën një hapësirë të sigurt: mbrojtjen nga dëmtimi, trajtimin e barabartë, respektimin e dinjitetit, parandalimin e diskriminimit dhe krijimin e mekanizmave të përshtatshëm për raportimin dhe referimin e shqetësimeve.
- **Privatësia, mbrojtja e të dhënave dhe siguria digjitale** - Një dimension tjetër i sigurisë lidhet me mënyrën se si mblidhen, përdoren, ruhen dhe publikohen të dhënat e të rinjve. Legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale përbën referencën kryesore kombëtare në këtë fushë. Ai duhet të merret parasysh për regjistrimin e pjesëmarrësve, listat e kontakteve, fotografitë dhe videot, administrimin e të dhënave të aktiviteteve, përdorimin e platformave digjitale dhe çdo përpunim tjetër të të dhënave personale. Kjo e zgjeron më tej kuptimin e hapësirës së sigurt: siguria duhet të mbrohet jo vetëm në mjedisin fizik dhe në marrëdhëniet ndërpersonale, por edhe në mënyrën se si menaxhohet informacioni dhe komunikimi digjital.

III. KONCEPTI, PARIMET DHE DIMENSIONET E HAPËSIRËS SË SIGURT PËR TË RINJTË

III.1. Koncepti i hapësirës së sigurt për të rinjtë

Kuadri politik i BE për rininë, përcakton se hapësirat e sigurta për të rinjtë lidhen me krijimin dhe ruajtjen e hapësirave fizike dhe virtuale që të jenë të sigurta, mikpritëse, gjithëpërfshirëse dhe të aksesueshme, ku të rinjtë mund të takohen, të shprehen, të marrin pjesë dhe të zhvillojnë potencialin e tyre. Gjithashtu, BE i jep një rëndësi të veçantë përfshirjes së të rinjve në projektimin dhe zhvillimin e hapësirave që u shërbejnë.

Legjislacioni shqiptar për rininë e përcakton shprehimisht konceptin e "hapësirës rinore të sigurt". Hapësira rinore e sigurt është çdo hapësirë ku të rinjtë ushtrojnë veprimtari dhe që përmbush standardet e përcaktuara në legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Për të rinjtë me aftësi të kufizuara, ligji kërkon zbatimin e elementeve të përshtatjes së arsyeshme, në përputhje me shkallën dhe llojin e aftësisë së kufizuar.

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels
(EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)
Funded by the European Union

Në këtë Udhëzues koncepti trajtohet në mënyrë më të gjerë, duke përfshirë, krahas kushteve fizike, edhe dimensionet psikologjike, sociale dhe digjitale, si dhe pjesëmarrjen e të rinjve. Ky zgjerim paraqet qasjen praktike të Udhëzuesit dhe nuk duhet të kuptohet si zëvendësim ose ndryshim i përkufizimit të përcaktuar në legjislacion.

Hapësira e sigurt për të rinjtë

Hapësira e sigurt për të rinjtë është çdo mjedis fizik, virtual ose i kombinuar, ku të rinjtë mund të takohen, të shprehen, të marrin pjesë, të mësojnë, të zhvillojnë potencialin e tyre dhe të ushtrojnë veprimtari në kushte sigurie, respekti, barazie, gjithëpërfshirjeje dhe aksesueshmërie. Këto hapësira duhet të ofrojnë një mjedis mikpritës dhe mbrojtës, të parandalojnë dhunën, diskriminimin, ngacmimin, abuzimin dhe çdo formë tjetër e sjelljes që cenon dinjitetin, mirëqenien dhe të drejtat e të rinjve.

Hapësirat e sigurta rinore planifikohen, zhvillohen dhe menaxhohen me pjesëmarrjen e të rinjve, duke vlerësuar diversitetin e tyre dhe nevojat e veçanta të të rinjve që përballen me pengesa ose kanë më pak mundësi. Siguria, aksesueshmëria, gjithëpërfshirja dhe mirëqenia e të rinjve duhet të konsiderohen në të gjitha fazat e projektimit, funksionimit, monitorimit dhe përmirësimit të hapësirës.

Siguria e një hapësire nuk përcaktohet vetëm nga kushtet fizike të ambientit. Ajo lidhet gjithashtu me cilësinë e marrëdhënieve, sjelljen e stafit dhe të personave të tjerë të angazhuar, mënyrën e organizimit të aktiviteteve, rregullat e funksionimit, mundësinë për të kërkuar ndihmë dhe mënyrën e trajtimit të shqetësimeve.

Një hapësirë mund të konsiderohet e sigurt për të rinjtë kur zbatohen masa të përshtatshme për parandalimin dhe menaxhimin e rreziqeve, përcaktohen përgjegjësi të qarta për sigurinë dhe mbrojtjen dhe funksionojnë mekanizma të aksesueshëm për raportimin dhe trajtimin e shqetësimeve. Siguria nuk është një gjendje që arrihet një herë e mbetet e pandryshuar; ajo kërkon vlerësim, pjesëmarrje, reagim dhe përmirësim të vazhdueshëm.

Në këtë Udhëzues, hapësirat e sigurta për të rinjtë përfshijnë:

- **hapësirat fizike**, si qendrat rinore, ambientet komunitare, bibliotekat, mjediset e aktiviteteve dhe ambientet e tjera ku zhvillohen aktivitete me të rinjtë;

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels
(EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)
Funded by the European Union

- **hapësirat sociale**, të krijuara përmes marrëdhënieve, ndërveprimit, bashkëpunimit dhe kulturës së respektit;
- **hapësirat digjitale**, si platformat online, grupet e komunikimit dhe mjediset virtuale të përdorura për informim, konsultim, organizim dhe pjesëmarrje rinore.



Figura nr. 1 Përbërja e hapësirave të sigurta për të rinjtë

Përgjegjësia për garantimin e hapësirave të sigurta për të rinjtë ndahet ndërmjet aktorëve sipas roleve dhe kompetencave të tyre. Institucioni ose ofruesi i hapësirës është përgjegjës për krijimin e kushteve dhe mekanizmave të nevojshëm; stafi dhe vullnetarët duhet të njohin dhe zbatojnë përgjegjësitë që lidhen me rolin e tyre; ndërsa të rinjtë duhet të informohen për të drejtat, rregullat, mekanizmat e pjesëmarrjes dhe mënyrat e raportimit. Krijimi dhe mirëmbajtja e hapësirave të sigurta për të rinjtë kërkon një proces të vazhdueshëm, që përfshin disa faza të ndërlidhura:

a) **Planifikim dhe krijim** – identifikimi i nevojave të të rinjve, vlerësimi i rreziqeve, përzgjedhja dhe përshtatja e ambientit dhe vlerësimi i aksesueshmërisë;
b) **Organizimi i aktiviteteve** – përcaktimi i përgjegjësive, informimi i pjesëmarrësve, rregullat e sjelljes dhe mbikëqyrja e përshtatshme;
c) **Funksionimi i përditshëm** – ruajtja e një mjedisi respektues, parandalimi i sjelljeve të dëmshme, mbrojtja e privatësisë dhe funksionimi i mekanizmave të raportimit;
d) **Vlerësimi dhe përmirësimi** – dëgjimi i të rinjve, identifikimi i rreziqeve dhe pengesave, shqyrtimi i shqetësimeve dhe përditësimi i masave të sigurisë.

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels
(EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)
Funded by the European Union

Gjithashtu, hapësira e sigurt për të rinjtë nuk duhet të ngatërrohet me shërbimin miqësor për të rinjtë, ato janë koncepte të lidhura, por janë të ndryshme. Shërbimet miqësore për të rinjtë synojnë që shërbimet të jenë të përshtatura me nevojat, karakteristikat dhe pritshmëritë e të rinjve, ndërsa siguria e hapësirës përqendrohet veçanërisht në parandalimin e dëmit, mbrojtjen e të drejtave, menaxhimin e rreziqeve dhe krijimin e kushteve të sigurta për pjesëmarrje. Të dyja qasjet duhet të plotësojnë njëra-tjetrën në një kornizë funksionale për të rinjtë.

III.2. Parimet themelore dhe dimensionet e sigurisë

Krijimi dhe funksionimi i hapësirave të sigurta duhet të mbështetet në parime të ndërlidhura që udhëheqin vendimmarrjen, organizimin e aktiviteteve, sjelljen e stafit dhe marrëdhëniet me të rinjtë. Këto parime[13] janë përmbledhur dhe përshtatur për qëllimet e këtij Udhëzuesi, duke u mbështetur në kuadrin ligjor, standardet dhe dokumentet politike evropiane e kombëtare të pasqyruara në kapitullin II. Ato nuk paraqiten si një listë e vetme e përcaktuar në një instrument të vetëm juridik, por si një kuadër praktik që ndihmon në përkthimin e kërkesave të ndryshme në mënyrën se si hapësirat për të rinjtë planifikohen dhe funksionojnë.

- **Respekti për të drejtat dhe dinjitetin -** Çdo i ri duhet të trajtohet me respekt dhe dinjitet, pa poshtërim, kërcënim, presion ose trajtim denigrues. Komunikimi dhe sjellja e stafit, vullnetarëve dhe personave të tjerë të përfshirë duhet të jenë të përshtatshme dhe të respektueshme.
- **Mosdiskriminimi dhe trajtimi i barabartë -** Hapësirat duhet të ofrojnë mundësi të barabarta pjesëmarrjeje dhe të parandalojnë diskriminimin, bullizmin, ngacmimin dhe përjashtimin. Kur të rinjtë përballen me pengesa të ndryshme, trajtimi i barabartë mund të kërkojë masa mbështetëse ose përshtatje të arsyeshme për të krijuar mundësi reale pjesëmarrjeje.
- **Gjithëpërfshirja dhe aksesueshmëria -** Aksesueshmëria përfshin jo vetëm mundësinë e hyrjes fizike, por edhe aksesin në informacion, komunikim, teknologji, aktivitete dhe mundësi pjesëmarrjeje. Aktorët përgjegjës duhet të identifikojnë dhe të reduktojnë pengesat që mund të pengojnë pjesëmarrjen e grupeve të ndryshme të të rinjve.
- **Mbrojtja dhe parandalimi i dëmit -** Hapësirat duhet të marrin masa për parandalimin, identifikimin dhe reagimin ndaj dhunës, abuzimit, ngacmimit, bullizmit, kërcënimeve dhe formave të tjera të sjelljes së dëmshme. Duhet të ekzistojnë mënyra të qarta për të kërkuar ndihmë, për të raportuar shqetësime dhe të referojnë rastet te strukturat kompetente.
- **Privatësia dhe konfidencialiteti -** Të dhënat personale dhe informacionet që lidhen me rrethanat personale të të rinjve duhet të trajtohen në mënyrë të sigurt dhe në përputhje me

[13] Aneksi nr. 1 "Matrica e vetëvlerësimit të parimeve të hapësirës së sigurt për të rinjtë" është mekanizmi praktik për aktorët përgjegjës për garantimin e parimeve.

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels
(EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)
Funded by the European Union

kërkesat ligjore. Të rinjtë duhet të informohen se si përdoren të dhënat e tyre dhe kush mund të aksesojë informacionin.

- **Pjesëmarrja e të rinjve -** Të rinjtë duhet të konsiderohen aktorë në krijimin dhe përmirësimin e hapësirës dhe jo vetëm përfitues të saj. Ata duhet të kenë mundësi të shprehin mendimet, të identifikojnë rreziqe dhe pengesat, të propozojnë përmirësime dhe të japin mendime mbi masat e ndërmarra. Pjesëmarrja duhet të jetë kuptimplotë dhe jo vetëm formale. Institucioni duhet të informojë të rinjtë se si është përfshirë kontributi i tyre.
- **Përgjegjshmëria dhe transparenca -** Duhet të jetë e qartë se kush është përgjegjës për sigurinë, ku mund të raportohet një shqetësim dhe si trajtohen çështjet e identifikuara. Informacioni për rregullat dhe mekanizmat e ndihmës duhet të jetë i aksesueshëm për të rinjtë.

Siguria e një hapësire për të rinjtë nuk përcaktohet vetëm nga zbatimi i parimeve, ekzistenca e rregullave dhe procedurave, por edhe nga mënyra se si ato zbatohen në praktikën e përditshme. Kultura e sigurisë nënkupton krijimin e një mjedisi ku respekti, komunikimi i përshtatshëm, parandalimi i dëmit, kërkimi i ndihmës dhe reagimi ndaj shqetësimeve konsiderohen përgjegjësi të përbashkëta. Institucioni dhe personat e angazhuar në hapësirë duhet të japin shembull përmes sjelljes së tyre, ndërsa të rinjtë duhet të informohen për rregullat, të drejtat dhe mënyrat e kërkimit të ndihmës. Një kulturë e tillë duhet të mbështesë raportimin e shqetësimeve pa frikë nga stigmatizimi, hakmarrja ose trajtimi i padrejtë.

Parimet e mësipërme konkretizohen përmes disa dimensioneve të sigurisë[14] që duhet të shqyrtohen gjatë planifikimit, funksionimit dhe vlerësimit të hapësirave për të rinjtë. Këto dimensione janë të ndërlidhura dhe duhet të vlerësohen së bashku, pasi mangësitë në njërin prej tyre mund të ndikojnë në sigurinë dhe pjesëmarrjen e të rinjve në tërësi.

- **Siguria fizike dhe kushtet e ambientit -** Hapësira duhet të jetë e mirëmbajtur dhe të reduktojë rreziqet e shmangshme për të rinjtë, stafin, vullnetarët dhe vizitorët. Në vlerësimin e sigurisë fizike duhet të shqyrtohen, sipas natyrës së hapësirës, gjendja e ambienteve dhe pajisjeve, hyrjet dhe daljet, ndriçimi, ajrimi, kushtet higjieno-sanitare, pajisjet e sigurisë dhe aksesueshmëria fizike. Kontrollet duhet të kryhen periodikisht dhe problemet që paraqesin rrezik duhet të adresohen.
- **Siguria psikologjike dhe emocionale -** Një hapësirë e sigurt duhet të krijojë një mjedis ku të rinjtë mund të shprehen dhe të marrin pjesë pa frikën e poshtërimit, kërcënimit, përjashtimit ose ndëshkimit të padrejtë. Kjo kërkon rregulla të qarta për sjelljen dhe respektin, komunikim të përshtatshëm, mundësi për të shprehur shqetësimet dhe reagim të përshtatshëm ndaj konflikteve, frikësimit ose përjashtimit. Kur një i ri ka nevojë për

[14] Aneksi Nr. 2 "Matrica e vetëvlerësimit të dimensioneve të sigurisë në hapësirën e sigurt për të rinjtë" është mekanizmi praktik për garantimin e dimensioneve të sigurisë nga aktorët përgjegjës.

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels
(EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)
Funded by the European Union

mbështetje të specializuar, personat që administrojnë hapësirën duhet të njohin kufijtë e rolit dhe të kompetencave të tyre dhe ta referojnë rastin te shërbimet ose strukturat përkatëse, sipas procedurave të zbatueshme.

- **Mbrojtja nga dhuna, abuzimi, ngacmimi dhe shfrytëzimi -** Hapësirat duhet të kenë masa parandaluese dhe procedura për identifikimin, raportimin dhe trajtimin e shqetësimeve që lidhen me dhunën, abuzimin, ngacmimin, bullizmin, kërcënimet ose shfrytëzimin. Këto masa duhet të përfshijnë, sipas rastit, rregulla të qarta, persona përgjegjës, mekanizma raportimi, informacion për kërkimin e ndihmës dhe procedura për referimin te strukturat kompetente. Mekanizmat e raportimit duhet të funksionojnë në mënyrë të tillë që personat që raportojnë një shqetësim të trajtohen me respekt dhe të mbrohen, në përputhje me legjislacionin dhe procedurat e zbatueshme, nga diskriminimi, stigmatizimi ose forma të tjera të trajtimit të padrejtë si pasojë e raportimit. Personat përgjegjës për hapësirën nuk duhet të kryejnë hetime ose vlerësime profesionale përtej rolit dhe kompetencave të tyre. Në rastet që kërkojnë ndërhyrje të specializuar, përgjegjësia e tyre është të ndjekin procedurën përkatëse, të marrin masat e menjëhershme që kërkohen për sigurinë dhe të realizojnë referimin te struktura ose autoriteti kompetent. Kur hapësira përdoret edhe nga persona nën moshën 18 vjeç, duhet të zbatohen kërkesat përkatëse të legjislacionit për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.
- **Mosdiskriminimi, gjithëpërfshirja dhe aksesueshmëria -** Siguria kërkon që të rinjtë të kenë mundësi reale për të përdorur hapësirën dhe për të marrë pjesë në aktivitetet e saj. Vlerësimi duhet të analizojë pengesat fizike, të komunikimit, digjitale, ekonomike dhe organizative. Masat për përmirësimin e aksesueshmërisë mund të përfshijnë përshtatjen e ambienteve, informacionit, pajisjeve, mënyrës së komunikimit, orareve dhe organizimit të aktiviteteve. Të rinjtë që përballen me pengesa të tilla duhet të përfshihen në identifikimin e tyre dhe në diskutimin e zgjidhjeve të mundshme.
- **Privatësia dhe konfidencialiteti -** Hapësira duhet të respektojë privatësinë e të rinjve gjatë komunikimit, ofrimit të mbështetjes dhe trajtimit të informacionit personal. Duhet të përcaktohet se çfarë informacioni mblidhet, për çfarë qëllimi përdoret, kush ka akses dhe si ruhet. Në rastet kur trajtohen shqetësime të ndjeshme, informacioni duhet të ndahet vetëm me personat ose strukturat që kanë rol të ligjshëm në trajtimin e tyre. Konfidencialiteti nuk është absolut dhe duhet të zbatohet në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ai nuk duhet të pengojë përmbushjen e detyrimeve ligjore për raportim ose marrjen e masave të nevojshme për mbrojtjen e një personi.
- **Siguria në mjedisin digjital -** Platformat online, grupet e komunikimit dhe rrjetet sociale që përdoren në lidhje me aktivitetet rinore duhet të konsiderohen pjesë e mjedisit të sigurisë. Duhet të merren masa për mbrojtjen e të dhënave, përdorimin e sigurt të llogarive dhe pajisjeve, komunikimin profesional, publikimin e fotografive dhe videove dhe

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels
(EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)
Funded by the European Union

trajtimin e përmbajtjeve ose sjelljeve të papërshtatshme dhe të dëmshme. Të rinjtë duhet të informohen edhe për mënyrat e raportimit të shqetësimeve që ndodhin në mjedisin digjital.

- **Siguria gjatë aktiviteteve jashtë hapësirës -** Kur aktivitetet zhvillohen jashtë ambientit të përhershëm, vlerësimi i sigurisë duhet të zgjerohet edhe te vendndodhja, transporti, itinerari, kohëzgjatja, kushtet e ambientit, nevojat e pjesëmarrësve dhe mundësia e reagimit në rast emergjence. Përpara aktivitetit duhet të përcaktohen përgjegjësitë, kontaktet, masat e transportit, nevojat për aksesueshmëri dhe mënyra e reagimit ndaj incidenteve. Kur aktivitetet përfshijnë persona nën moshën 18 vjeç, masat organizative dhe mbikëqyrja duhet të përshtaten me moshën e pjesëmarrësve, natyrën e aktivitetit dhe kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e fëmijës.
- **Gatishmëria për emergjenca -** Hapësirat duhet të jenë të përgatitura për situata që mund të rrezikojnë sigurinë e pjesëmarrësve, si zjarri, tërmeti, përmbytjet, emergjencat shëndetësore ose situata të tjera. Gatishmëria duhet të përfshijë identifikimin e rreziqeve, përcaktimin e përgjegjësive, rrugët e evakuimit, pikat e grumbullimit, kontaktet e emergjencës dhe masat për personat që mund të kenë nevojë për mbështetje. Procedurat e emergjencës duhet të jenë të dokumentuara, të kuptueshme për stafin dhe të komunikuara në mënyrë të përshtatshme me të rinjtë që përdorin hapësirën. Ato duhet të përfshijnë mbështetjen që mund t'u nevojitet personave gjatë evakuimit ose në situata të tjera emergjente.

Siguria e hapësirës është rezultat i ndërveprimit të kushteve fizike, mënyrës së organizimit, sjelljes së personave të përfshirë dhe përvojës së të rinjve. Parimet dhe dimensionet e sigurisë të paraqitura më sipër përbëjnë bazën mbi të cilën institucionet dhe aktorët përgjegjës duhet të planifikojnë, organizojnë dhe monitorojnë hapësirat e përdorura nga të rinjtë. Për ta përkthyer këtë kuadër në praktikë, institucioni duhet të përcaktojë se cilat kushte dhe masa duhet të jenë të pranishme dhe si do të garantohet funksionimi i tyre në praktikë.

Çfarë duhet të garantojë institucioni për një hapësirë të sigurt për të rinjtë?

Institucioni ose aktori përgjegjës për krijimin, administrimin apo funksionimin e një hapësire të përdorur nga të rinjtë duhet të marrë masa për të garantuar kushtet bazë të sigurisë, mbrojtjes, aksesueshmërisë, përfshirjes dhe pjesëmarrjes. Duke marr parasysh natyrën dhe funksionin e hapësirës, këto masa duhet të përfshijnë, sipas rastit:

- **Ambient të sigurt dhe të mirëmbajtur -** ambienti dhe pajisjet duhet të jenë në gjendje të përshtatshme përdorimi dhe të mos paraqesin rreziqe të shmangshme për përdoruesit;
- **Rregulla të qarta dhe të komunikuara -** rregullat e përdorimit dhe sjelljes duhet të jenë të qarta, të aksesueshme dhe të komunikuara me të rinjtë;

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels (EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)
Funded by the European Union

- **Person ose persona përgjegjës të përcaktuar** - duhet të jetë e qartë kush ka përgjegjësi për funksionimin e hapësirës dhe për trajtimin e shqetësimeve;
- **Mekanizëm të aksesueshëm për raportimin e shqetësimeve -** të rinjtë duhet të kenë një mënyrë të qartë dhe të përshtatshme për të kërkuar ndihmë ose për të raportuar një shqetësim;
- **Procedurë për reagimin dhe referimin -** duhet të përcaktohet se si trajtohet një shqetësim dhe, kur është e nevojshme, si referohet te struktura ose autoriteti kompetent;
- **Masa për privatësinë dhe mbrojtjen e të dhënave -** informacioni personal duhet të trajtohet në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurat përkatëse;
- **Masa për aksesueshmërinë dhe përfshirjen -** duhet të identifikohen dhe, sa është e mundur, të adresohen pengesat që kufizojnë përdorimin dhe pjesëmarrjen e të rinjve;
- **Informim të të rinjve për të drejtat dhe mënyrat e kërkimit të ndihmës -** të rinjtë duhet të dinë rregullat, të drejtat e tyre, personat përgjegjës dhe mënyrat për të kërkuar ndihmë ose për të raportuar shqetësime;
- **Përgatitje për emergjenca -** duhet të ketë masa dhe procedura të përshtatshme për reagimin ndaj emergjencave dhe situatave të tjera që mund të cenojnë sigurinë;
- **Mekanizëm për marrjen e mendimeve të të rinjve -** të rinjtë duhet të kenë mundësi të japin mendime mbi sigurinë, funksionimin dhe përmirësimin e hapësirës;
- **Monitorim dhe rishikim periodik -** kushtet, rreziqet, masat e sigurisë dhe përvoja e të rinjve duhet të rishikohen në mënyrë periodike dhe sa herë që është e nevojshme.

Këto elemente nuk duhet të kuptohen si një listë shteruese ose si kërkesa të njëjta për çdo lloj hapësire. Ato shërbejnë si një pikënisje praktike për institucionet dhe aktorët përgjegjës për të vlerësuar nëse janë krijuar kushtet bazë për një hapësirë të sigurt për të rinjtë.

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels
(EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)
Funded by the European Union

IV. KRIJIMI I HAPËSIRAVE TË SIGURTA PËR TË RINJTË NË SHQIPËRI

IV.1. Siguria e hapësirës dhe përgjegjësia institucionale

Për institucionet shtetërore shqiptare dhe aktorët e tjerë që krijojnë, administrojnë, financojnë ose mbështesin hapësira të përdorura nga të rinjtë, siguria duhet të jetë pjesë e mënyrës së planifikimit, organizimit dhe funksionimit të hapësirës. Një hapësirë nuk konsiderohet e sigurt vetëm sepse plotëson disa kushte fizike ose sepse institucioni ka miratuar rregulla të brendshme. Siguria kërkon që institucioni të ketë identifikuar rreziqet, të ketë marrë masat për t'i parandaluar ose reduktuar ato, të ketë përcaktuar përgjegjësi të qarta dhe të sigurojë që masat të funksionojnë në praktikë.

Kjo përgjegjësi duhet të fillojë që në momentin kur planifikohet krijimi, përshtatja ose vënia në dispozicion e një hapësire për të rinjtë. Institucioni duhet të përcaktojë grupet e synuara të përdoruesve, aktivitetet që do të zhvillohen, oraret e përdorimit dhe karakteristikat e zonës dhe të ndërtesës. Këto të dhëna duhet të përdoren për të identifikuar rreziqet dhe nevojat që duhet të adresohen përpara dhe gjatë funksionimit të hapësirës. Këto të dhëna duhet të përdoren për të identifikuar rreziqet dhe nevojat që duhet të adresohen përpara dhe gjatë funksionimit.

Institucionet shtetërore dhe aktorët e tjerë përgjegjës duhet të fillojnë procesin për krijimin dhe menaxhimin e hapësirave të sigurta për të rinjtë, duke përcaktuar qartë përgjegjësitë dhe detyrat e aktorëve të përfshirë[15].

Procesi nuk nënkupton që aktorët përgjegjës duhet të krijojnë një strukturë të re administrative apo një sistem të veçantë dokumentacioni për realizimin e tij. Sipas madhësisë, funksionit, numrit të përdoruesve dhe nivelit të rrezikut, aktorët përgjegjës mund të përdorin strukturat, procedurat dhe burimet që tashmë kanë në dispozicion, duke i përshtatur ato me nevojat e hapësirës. Për një hapësirë të vogël që përdoret periodikisht për aktivitete rinore, masat mund të jenë të thjeshta dhe të integruara në procedurat ekzistuese. Për një strukturë që funksionon çdo ditë dhe pret një numër të madh të rinjsh, veçanërisht kur ofron shërbime ose zhvillon aktivitete me nivele më të larta të rrezikut, mund të kërkohet një organizim më i strukturuar i përgjegjësive, procedurave, trajnimit, dokumentimit dhe monitorimit.

Gjithashtu, krijimi i hapësirave të sigurta për të rinjtë kërkon qasje të ndryshme në varësi të faktit nëse bëhet fjalë për një hapësirë ekzistuese që duhet të përshtatet dhe përmirësohet, apo për një hapësirë të re që planifikohet dhe krijohet. Në të dyja rastet, siguria duhet të trajtohet si pjesë e integruar e planifikimit, organizimit dhe funksionimit të hapësirës dhe jo si një masë që ndërmerret vetëm pasi hapësira është krijuar. Për hapësirat ekzistuese, procesi nis me vlerësimin e situatës aktuale, identifikimin e rreziqeve dhe pengesave dhe përcaktimin e masave për përmirësim. Për

[15] Aneksi nr. 3 "Matrica për zbatimin e procesit të krijimit dhe menaxhimit të një hapësire të sigurt për të rinjtë" është mekanizmi praktikë që ndihmon aktorët përgjegjës për realizimin e procesit.

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels
(EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)
Funded by the European Union

hapësirat e reja, parimet e sigurisë, aksesueshmërisë, mbrojtjes dhe pjesëmarrjes së të rinjve duhet të përfshihen që në fazat e hershme të planifikimit dhe projektimit.

Në të gjitha rastet, institucioni duhet të jetë në gjendje të tregojë jo vetëm se çfarë dokumentesh ka miratuar, por se çfarë masash ka marrë, kush është përgjegjës, si informohen dhe si dëgjohen të rinjtë, si trajtohen shqetësimet dhe si vlerësohet nëse masat funksionojnë. Krijimi i një hapësire të sigurt nuk është një veprim i vetëm dhe as një status që arrihet një herë. Për institucionet shqiptare, ai duhet të trajtohet si një proces i vazhdueshëm i vlerësimit, planifikimit, zbatimit, informimit, monitorimit dhe përmirësimit, në të cilin siguria e të rinjve është pjesë e funksionimit të përditshëm të hapësirës.

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels
(EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)
Funded by the European Union




Figura nr. 2 Procesi i krijimit dhe menaxhimit të hapësirës së sigurt për të rinjtë

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels
(EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)

Funded by the European Union

i. **Institucioni duhet të kryejë një vlerësim fillestar të sigurisë së hapësirës**. Ky vlerësim duhet të shqyrtojë kushtet fizike të ambientit, hyrjet dhe daljet, ndriçimin, shkallët dhe korridoret, kushtet e higjienës, daljet e emergjencës, pajisjet dhe mobilimin, aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara, mundësinë për privatësi dhe sigurinë e zonës përreth. Për hapësirat ekzistuese, vlerësimi duhet të evidentojë edhe mangësitë që kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme, masa organizative ose investime afatmesme dhe afatgjata.

ii. **Identifikimi i rreziqeve**. Duhet të identifikohen dhe të vlerësohen rreziqet që mund të ndikojnë në sigurinë dhe mirëqenien e të rinjve gjatë përdorimit të hapësirës. Përveç rreziqeve fizike, institucioni duhet të përfshijë edhe mundësinë e bullizmit, diskriminimit, ngacmimit, dhunës, abuzimit, shfrytëzimit, konfliktit, cenimit të privatësisë ose përdorimit të pasigurt të mjeteve dhe kanaleve digjitale. Për aktivitete jashtë ambienteve të zakonshme duhet të analizohen edhe rreziqet që lidhen me transportin, vendndodhjen dhe organizimin e aktivitetit.

iii. **Konsultimi me të rinjtë**. Duhet të konsultohen të rinjtë që do ta përdorin hapësirën. Konsultimi nuk duhet të kufizohet në pyetjen nëse ata e pëlqejnë hapësirën. Të rinjtë duhet të kenë mundësi të identifikojnë vende ose situata në të cilat ndihen të pasigurt, pengesa për aksesin dhe përdorimin e hapësirës, probleme që lidhen me privatësinë, oraret, rregullat dhe mënyrën e komunikimit. Institucioni duhet të sigurojë që në këtë proces të dëgjohen edhe të rinj me aftësi të kufizuara, të rinj nga grupe të ndryshme dhe, sipas natyrës së hapësirës, të rinj me përvoja ose nevoja të ndryshme.

iv. **Plani i masave**. Gjetjet duhet të përkthehen në një plan masash. Institucioni duhet të përcaktojë se cilat problematika kërkojnë ndërhyrje, çfarë duhet bërë, kush është përgjegjës, cilat janë afatet dhe cilat burime nevojiten. Masat mund të jenë të menjëhershme dhe me kosto të ulët, si përmirësimi i ndriçimit, sinjalistikës, informimit ose rregullave të përdorimit; organizative, si përcaktimi i përgjegjësive dhe procedurave; ose strukturore, kur kërkohen ndërhyrje fizike apo investime.

v. **Rregullat e funksionimit dhe ndarja e përgjegjësive**. Për çdo hapësirë duhet të jetë e qartë kush e administron atë, kush është përgjegjës për çështjet e sigurisë, kush mbikëqyr aktivitetet dhe kush vepron pas raportimit të një shqetësimi. Rregullat e përdorimit duhet të jenë të thjeshta, të kuptueshme dhe të dukshme për përdoruesit[16]. Ato duhet të përcaktojnë sjelljet e pritshme, mënyrën e përdorimit të ambienteve dhe pajisjeve dhe mënyrën se si trajtohen situatat që cenojnë sigurinë ose të drejtat e të rinjve.

vi. **Përcaktimi i mekanizmave të raportimit**, **reagimit dhe referimit.** Të rinjtë duhet të dinë se kujt mund t'i drejtohen nëse përjetojnë ose vërejnë një situatë shqetësuese. Stafi duhet

[16] Aneksi nr. 7 "Model orientues i rregullave të hapësirës" është mekanizmi praktik për informimin e rregullave të hapësirës së sigurt për të rinjtë.

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels
(EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)
Funded by the European Union

të dijë çfarë duhet të bëjë pas marrjes së një raportimi dhe në cilat raste kërkohet përfshirja e strukturave ose shërbimeve të tjera kompetente. Mekanizmat duhet të respektojnë privatësinë, konfidencialitetin dhe të drejtat e personave të përfshirë dhe të funksionojnë në përputhje me legjislacionin dhe procedurat përkatëse. Personat përgjegjës për hapësirën nuk duhet të kryejnë hetime ose vlerësime profesionale përtej rolit dhe kompetencave të tyre. Në rastet që kërkojnë ndërhyrje të specializuar, përgjegjësia e tyre është të ndjekin procedurën përkatëse, të marrin masat e menjëhershme që kërkohen për sigurinë dhe të realizojnë referimin te struktura ose autoriteti kompetent.

vii. **Përgatitja dhe zhvillimi i kapaciteteve të stafeve[17].** Personat që kanë kontakt të drejtpërdrejtë me të rinjtë duhet të njohin rregullat e hapësirës, përgjegjësitë e tyre, mënyrën e identifikimit dhe raportimit të shqetësimeve dhe mënyrën e reagimit, në përputhje me rolin dhe kompetencat e tyre. Në përshtatje me funksionin e hapësirës dhe profilit të përdoruesve, institucioni duhet të sigurojë edhe orientim ose trajnim të përshtatshëm për mbrojtjen, përfshirjen, aksesueshmërinë, komunikimin me të rinjtë dhe menaxhimin e situatave të vështira. Institucioni duhet të kujdeset edhe për sigurinë dhe mirëqenien e stafit, vullnetarëve dhe personave të tjerë të angazhuar në hapësirë, veçanërisht gjatë menaxhimit të situatave konfliktuale, incidenteve ose emergjencave. Personat e angazhuar duhet të kenë informacion, udhëzime dhe mbështetje të përshtatshme për ushtrimin e rolit të tyre.

viii. **Informimi i të rinjve.** Të rinjtë duhet të informohen për mënyrën e funksionimit të hapësirës dhe për të drejtat e tyre. Informacioni duhet të jetë i disponueshëm dhe i kuptueshëm dhe, sipas nevojës, të ofrohet në forma të aksesueshme. Në fillim të përdorimit të hapësirës, të rinjtë duhet të marrin informacion të qartë dhe të përshtatshëm për rregullat e hapësirës, personat përgjegjës, mënyrat e kërkimit të ndihmës dhe raportimit të shqetësimeve, si dhe për mënyrën se si trajtohen informacionet personale. Informacioni duhet të jetë i aksesueshëm dhe të përshtatet, kur është e nevojshme, me moshën, aftësitë dhe nevojat e përdoruesve. Informimi duhet të jetë pjesë e funksionimit të përditshëm dhe jo vetëm një aktivitet në momentin e hapjes së hapësirës.

ix. **Garantimi i mekanizmave të marrjes së mendimeve.** Institucioni duhet të sigurojë mekanizma të rregullt për marrjen e mendimeve të të rinjve. Mendimet mund të mblidhen përmes bisedave të drejtpërdrejta, takimeve me grupet rinore, pyetësorëve të shkurtër, kutive të sugjerimeve ose mjeteve digjitale, sipas karakteristikave të hapësirës. Rëndësi ka që të rinjtë të shohin se shqetësimet dhe sugjerimet e tyre merren në konsideratë dhe se institucioni komunikon, se çfarë është ndryshuar ose përmirësuar në përgjigje të kontributit të tyre.

[17] Aneksi nr. 8 "Tabelë orientuese për stafin dhe personat përgjegjës për një hapësirë të sigurt për të rinjtë" është mekanizmi praktik për fuqizimin e kapaciteteve administrative.

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels
(EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)
Funded by the European Union

x. **Monitorimi dhe përmirësimi.** Institucioni duhet të monitorojë dhe të rishikojë masat e sigurisë. Pas zbatimit të masave, duhet të kontrollohet nëse ato funksionojnë në praktikë, nëse janë shfaqur rreziqe të reja dhe nëse nevojat e përdoruesve kanë ndryshuar ose janë shfaqur nevoja të reja. Monitorimi nuk duhet të jetë vetëm kontroll dokumentesh. Ai duhet të përfshijë, sipas rastit, vëzhgimin e hapësirës, komunikimin me të rinjtë dhe stafin, shqyrtimin e shqetësimeve të raportuara dhe verifikimin e zbatimit të masave të përcaktuara. Në rastet kur identifikohen mangësi, institucioni duhet të përcaktojë masat korrigjuese dhe afatet për zbatimin e tyre. Nëse një problem nuk mund të zgjidhet menjëherë, ai duhet të dokumentohet dhe të përfshihet në planifikimin e mëtejshëm të institucionit, duke përcaktuar masat e përkohshme që mund të merren për të reduktuar rrezikun deri në zgjidhjen përfundimtare.

IV.1.1. Nga hapësira ekzistuese drejt një hapësire të sigurt

Në Shqipëri, krijimi i hapësirave të sigurta për të rinjtë nuk nënkupton domosdoshmërisht ndërtimin e hapësirave të reja. Në shumë raste, aktorët përgjegjës, veçanërisht institucionet shtetërore qendrore dhe vendore, kanë tashmë në dispozicion ambiente që mund të përdoren nga të rinjtë, por që kërkojnë përshtatje të kushteve fizike, mënyrës së administrimit, rregullave të përdorimit dhe mekanizmave të mbrojtjes. Për këtë arsye, procesi duhet të fillojë me vlerësimin nëse hapësira ekzistuese është realisht e sigurt për të rinjtë që e përdorin atë.

Vlerësimi duhet të shkojë përtej kontrollit të gjendjes fizike të godinës. Ai duhet të shqyrtojë mënyrën se si të rinjtë e përdorin hapësirën, si ndihen në të, me çfarë rreziqesh mund të përballen, sa lehtë mund të kërkojnë ndihmë dhe nëse institucionet kanë kapacitetin për të reaguar. Vlerësimi i sigurisë duhet të përfshijë edhe mjedisin përreth hapësirës, përfshirë aksesin në këmbë, lidhjen me transportin, ndriçimin, hyrjet dhe daljet, si dhe faktorë të tjerë të zonës që mund të ndikojnë në sigurinë e të rinjve gjatë ardhjes në hapësirë dhe largimit prej saj.

Për këtë qëllim, rekomandohet që institucionet të ndjekin procesin e mëposhtëm për përmirësimin dhe menaxhimin e hapësirës së sigurt për të rinjtë:

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels
(EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)
Funded by the European Union




Figura nr. 3 Procesi i përmirësimit dhe menaxhimit të hapësirës ekzistuese për të rinjtë

i. Vlerëso

Aktorët përgjegjës duhet fillimisht të përcaktojnë qartë se cila hapësirë do të përdoret nga të rinjtë dhe si do të përdoret ajo. Vlerësimi i hapësirës ekzistuese duhet të përfshijë të paktën: vendndodhjen dhe aksesin në hapësirë; ambientet që përdoren nga të rinjtë; oraret dhe mënyrën e përdorimit; aktivitetet që zhvillohen; personat që kanë akses në hapësirë; mënyrën e mbikëqyrjes; kushtet fizike dhe të mirëmbajtjes; aksesueshmërinë për të rinjtë me aftësi të kufizuara; hapësirat ku mund të ketë nevojë për privatësi; mundësitë për raportimin e shqetësimeve; informacionin që u jepet të rinjve; përdorimin e pajisjeve dhe platformave digjitale.

Vlerësimi nuk duhet të kufizohet në një kontroll administrativ. Ai duhet të evidentojë çfarë funksionon, ku janë mangësitë dhe cilat ndryshime janë të nevojshme[18].

ii. Identifiko

Pas vlerësimit fillestar, aktorët përgjegjës duhet të identifikojnë rreziqet dhe mangësitë që mund të ndikojnë në sigurinë dhe mirëqenien e të rinjve. Rreziqet mund të lidhen me:

- **Mjedisin fizik:** hyrje të pasigurta, ndriçim të pamjaftueshëm, pajisje të dëmtuara, dalje emergjence, shkallë, dysheme, mobilim ose kushte të tjera të ambientit.

[18] Aneksi nr. 4 "Lista e kontrollit për krijimin dhe funksionimin e një hapësire të sigurt për të rinjtë".

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels
(EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)
Funded by the European Union

- **Organizimin:** mungesën e rregullave të qarta, mungesën e personave përgjegjës, mbikëqyrjen e pamjaftueshme ose paqartësinë për mënyrën e reagimit ndaj një shqetësimi.
- **Marrëdhëniet dhe sjelljen:** konflikte, bullizëm, ngacmim, diskriminim, përjashtim ose sjellje të tjera që mund të krijojnë një mjedis jo të sigurt.
- **Aksesueshmërinë:** pengesa fizike, pengesa në komunikim ose mënyra organizimi që pengojnë pjesëmarrjen e disa të rinjve.
- **Privatësinë:** mungesë të hapësirave të përshtatshme për komunikime konfidenciale ose trajtim jo të përshtatshëm të informacionit personal.
- **Mjedisin digjital:** përdorim të pasigurt të pajisjeve, platformave ose kanaleve të komunikimit të lidhura me aktivitetet e hapësirës.

Masat e sigurisë duhet të përshtaten me natyrën e aktivitetit. Për aktivitetet që paraqesin rreziqe të veçanta për shkak të vendndodhjes, natyrës së aktivitetit, përdorimit të pajisjeve, transportit ose karakteristikave të pjesëmarrësve, duhet të kryhet një vlerësim i posaçëm i rreziqeve dhe të përcaktohen masat përkatëse përpara zhvillimit të aktivitetit.

Jo çdo mangësi ka të njëjtin nivel urgjence. Institucioni duhet të përcaktojë cilat çështje kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme, cilat mund të adresohen në një periudhë të shkurtër dhe cilat mund të planifikohen si pjesë e përmirësimeve të mëtejshme.

iii. Dëgjo të rinjtë

Institucioni nuk duhet të vendosë në mënyrë të njëanshme nëse një hapësirë është e sigurt. Të rinjtë që e përdorin hapësirën duhet të kenë mundësi të shprehin mendimin e tyre mbi: ambientet që i konsiderojnë të sigurta; ambientet ose situatat që u krijojnë shqetësim; ndjesitë që kanë në frekuentimin e hapësirës; informacionin që kanë se kujt duhet t'i drejtohen kur kanë një problem; ndryshimet që do ta bënin hapësirën më të sigurt; pengesat për pjesëmarrjen e tyre.

Konsultimi[19] mund të realizohet nëpërmjet takimeve me të rinjtë, pyetësorëve të shkurtër, diskutimeve në grup, hartës së sigurisë së hapësirës ose formave të tjera të përshtatshme. Institucioni duhet të sigurojë që konsultimi të mos jetë vetëm formal. Nëse të rinjtë identifikojnë një problem, duhet të përcaktohet nëse dhe si ai do të adresohet dhe, kur është e mundur, t'u komunikohet atyre rezultati.

iv. Vepro

[19] Aneksi nr. 5 "Mjetet për pjesëmarrjen dhe marrjen e mendimeve të të rinjve" është mekanizmi praktik për pjesëmarrjen e të rinjve në procesin e krijimit dhe menaxhimit të hapësirës së sigurt për të rinjtë.

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels
(EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)
Funded by the European Union

Pas vlerësimit dhe konsultimit, aktorët përgjegjës duhet të përcaktojnë çfarë duhet të ndryshojë, duke hartuar "Planin e Veprimit"[20], i cili përcakton në mënyrë të detajuar problematikat, personat përgjegjës, afatet dhe masat që duhet të ndërmerren. Për një hapësirë ekzistuese, masat mund të jenë:

- **Masa fizike** - Përmirësimi i ndriçimit, riparimi i elementeve të dëmtuara, riorganizimi i mobilimit, përmirësimi i aksesit, krijimi i hapësirave të përshtatshme për privatësi ose masa të tjera të nevojshme.
- **Masa organizative** - Përcaktimi i përgjegjësive, rregullat e përdorimit, organizimi i mbikëqyrjes, procedurat për raportimin e shqetësimeve dhe mënyra e reagimit.
- **Masa për mbrojtjen dhe përfshirjen** - Informimi i stafit, rritja e kapaciteteve, masa kundër diskriminimit dhe përjashtimit dhe përshtatja e mënyrës së ofrimit të aktiviteteve për të rinj me nevoja të ndryshme.
- **Masa për informacionin dhe komunikimin** - Vendosja e informacionit të qartë për rregullat e hapësirës, personin e kontaktit, mënyrat e raportimit dhe shërbimet ku mund të kërkohet mbështetje.
- **Masa digjitale** - Përcaktimi i mënyrës së sigurt të përdorimit të pajisjeve, të dhënave dhe kanaleve digjitale që lidhen me hapësirën. Plani duhet të përcaktojë për secilën masë: çfarë do të bëhet; kush është përgjegjës; kur do të bëhet; cilat burime nevojiten; si do të kontrollohet zbatimi.

Jo të gjitha masat kërkojnë të njëjtin nivel burimesh. Institucionet duhet të dallojnë ndërmjet:

- **Masave të menjëhershme**, që lidhen me rreziqe që nuk mund të lihen pa adresuar;
- **Masave me kosto të ulët**, që mund të zbatohen shpejt përmes ndryshimeve në organizim, informacion, rregulla ose mënyrën e përdorimit të hapësirës;
- **Masave të planifikuara**, që kërkojnë investime, rikonstruksion, pajisje ose burime të tjera dhe duhet të përfshihen në planifikimin dhe buxhetimin përkatës.

Kjo qasje ndihmon që mungesa e një investimi të madh të mos përdoret si arsye për të mos ndërmarrë masa të tjera që mund të zbatohen menjëherë.

v. Zbato

Pas përcaktimit të masave prioritare, institucioni fillon zbatimin e tyre në përputhje me përgjegjësitë, afatet dhe burimet e përcaktuara.

[20] Aneksi nr. 6 "Plan Veprimi për krijimin dhe funksionimin e një hapësire të sigurt për të rinjtë" është mekanizmi praktik për hartimin e tij.

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels
(EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)
Funded by the European Union

Masat mund të jenë fizike, organizative, procedurale ose të lidhen me mënyrën e funksionimit dhe menaxhimit të hapësirës. Zbatimi duhet të jetë proporcional me nevojat dhe nivelin e rrezikut të identifikuar.

vi. Informo

Të rinjtë[21] duhet të informohen në mënyrë të qartë dhe të aksesueshme për masat që janë marrë për sigurinë e tyre, rregullat e përdorimit të hapësirës, mënyrat për të shprehur shqetësime ose për të raportuar një problem dhe burimet e mbështetjes që janë në dispozicion. Informimi duhet të përshtatet me moshën, nevojat dhe karakteristikat e përdoruesve të hapësirës.

vii. Monitoro

Institucioni monitoron nëse masat e zbatuara funksionojnë në praktikë dhe nëse hapësira vazhdon të jetë e sigurt, e aksesueshme dhe gjithëpërfshirëse.

Monitorimi mund të mbështetet në vëzhgime të rregullta, komunikimin me të rinjtë dhe stafin, identifikimin e problematikave të reja dhe shqyrtimin e rasteve ose shqetësimeve të raportuara. Kur identifikohen mangësi ose rreziqe të reja, ato duhet të vlerësohen dhe të trajtohen në përputhje me nivelin e rrezikut.


viii. Përmirëso

Gjetjet nga monitorimi përdoren për të përshtatur ose përmirësuar masat e marra. Kur evidentohen rreziqe, pengesa ose nevoja të reja, institucioni rishikon masat dhe përcakton ndërhyrjet e nevojshme. Përmirësimi duhet të jetë një proces i vazhdueshëm dhe, sa herë që është e mundur, të mbështetet edhe në përvojën dhe sugjerimet e të rinjve.

Në këtë mënyrë, krijimi dhe përshtatja e një hapësire të sigurt nuk përfundon me marrjen e masave, por vijon përmes informimit, monitorimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm.

IV.1.2. Hapësirë e re për të rinjtë dhe projektimi i sigurisë

Në rastin e krijimit të një hapësire të re për të rinjtë, aktorët përgjegjës duhet të shmangin qasjen sipas së cilës siguria kontrollohet vetëm pasi hapësira të jetë ndërtuar ose inauguruar. Siguria duhet të jetë pjesë e planifikimit që në fazën e parë. Para projektimit ose përshtatjes së ambientit, aktorët përgjegjës duhet të përcaktojnë përgjigjet për disa pyetje themelore:



[21] Tre etapat: informo, monitoro dhe përmirëso i gjeni të detajuara në Kapitullin V të këtij Udhëzuesi.

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels
(EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)
Funded by the European Union



Këto çështje duhet të analizohen përpara se të përcaktohet përfundimisht projekti dhe mënyra e funksionimit. Për një hapësirë të re rekomandohet të ndiqet një proces i detajuar për garantimin e sigurisë së saj:

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels
(EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)
Funded by the European Union




Figura nr. 4 Procesi i garantimit të një hapësire të re të sigurt për të rinjtë

i. **Analizo nevojat -** Identifikohen të rinjtë që do ta përdorin hapësirën, nevojat e tyre dhe funksionet që duhet të mbulojë.

ii. **Vlerëso vendndodhjen -** Shqyrtohen aksesueshmëria, lidhja me transportin, siguria e zonës përreth dhe kushtet e hyrje-daljeve. Vlerësim duhet të marrë përfshijë edhe natyrën e aktiviteteve që planifikohen të zhvillohen në hapësirë dhe masat e sigurisë që mund të kërkohen për aktivitete me rrezik të veçantë.

iii. **Projekto hapësirën -** Siguria, aksesueshmëria, privatësia, ndriçimi, orientimi dhe përdorimi fleksibël i ambienteve duhet të integrohen në projekt..

iv. **Administro -** Përcaktohen drejtimi, stafi, përgjegjësitë dhe rregullat e përdorimit.

v. **Mekanizmat e mbrojtjes -** Përpara hapjes duhet të jenë të përcaktuara mënyrat e raportimit, reagimit, referimit dhe komunikimit përkatës me të rinjtë.

vi. **Informo të rinjtë -** Para fillimit të funksionimit, rekomandohet që të rinjtë të informohen për rregullat, të drejtat, mënyrat e marrjes së mendimeve dhe ku mund të kërkojnë ndihmë.

vii. **Testo para hapjes -** Institucioni duhet të kontrollojë në praktikë nëse hapësira funksionon siç është planifikuar. Është e dobishme që një grup të rinjsh të përfshihet në këtë fazë për të identifikuar probleme që mund të mos jenë evidentuar gjatë projektimit.

viii. **Hap dhe monitoro -** Pas hapjes, institucioni duhet të mbledhë mendimet dhe të korrigjojë mangësitë e identifikuara.

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels
(EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)
Funded by the European Union

V. GARANTIMI I HAPËSIRAVE TË SIGURTA PËR TË RINJTË - NJË PROCES INSTITUCIONAL I VAZHDUESHËM

V.1. Procesi institucional i garantimit të hapësirave të sigurta për të rinjtë

Siguria e një hapësire për të rinjtë nuk përfundon me krijimin e saj, përshtatjen e një hapësire ekzistuese ose miratimin e rregullave të funksionimit. Nevojat e të rinjve, mënyra se si përdoret hapësira dhe rreziqet që mund të shfaqen mund të ndryshojnë me kalimin e kohës. Për këtë arsye, aktorët përgjegjës duhet të kenë një qasje të vazhdueshme për të vlerësuar nëse masat e vendosura funksionojnë në praktikë dhe nëse kërkohen ndryshime ose masa të reja. Ky proces përfshin një cikël të vazhdueshëm të:




Figura nr. 5 Cikli i përmirësimit të vazhdueshëm

Niveli i institucionalizimit dhe shpeshtësia e këtij procesi duhet të përshtaten me madhësinë, funksionin, numrin e përdoruesve dhe nivelin e rrezikut të hapësirës.

i. Vetëvlerësimi i hapësirës

Vetëvlerësimi është procesi përmes të cilit aktorët përgjegjës shqyrtojnë nëse hapësira dhe mënyra e funksionimit të saj vazhdojnë të përmbushin kërkesat themelore të sigurisë. Vetëvlerësimi duhet të shqyrtojë, sipas rastit:

- kushtet fizike dhe aksesueshmërinë e hapësirës;
- sigurinë dhe organizimin e ambienteve;

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels
(EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)
Funded by the European Union

- rregullat dhe procedurat e funksionimit;
- përgjegjësitë e stafit dhe personave të angazhuar në hapësirë;
- mekanizmat e raportimit, reagimit dhe referimit;
- mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave;
- informimin e të rinjve;
- mundësitë për marrjen e mendimeve;
- problematikat ose shqetësimet e evidentuara gjatë funksionimit.

Vetëvlerësimi nuk duhet të kuptohet si një proces i orientuar vetëm drejt dokumentacionit. Qëllimi i tij është të identifikojë nëse masat e përcaktuara funksionojnë në praktikë dhe nëse nevojiten ndërhyrje të mëtejshme. Gjithashtu, pas një incidenti ose shqetësimi të rëndësishëm, institucioni duhet të vlerësojë jo vetëm mënyrën se si është trajtuar rasti, por edhe nëse incidenti evidenton një dobësi në mënyrën e organizimit ose funksionimit të hapësirës. Kur është e nevojshme, gjetjet duhet të përdoren për përditësimin e rregullave, procedurave, trajnimit ose masave të tjera parandaluese.

Për hapësirat ekzistuese, vetëvlerësimi mund të përdoret për të verifikuar nëse masat e ndërmarra për përshtatjen dhe përmirësimin e hapësirës kanë dhënë rezultat. Për hapësirat e reja, ai ndihmon në identifikimin e problematikave që mund të shfaqen pas fillimit të funksionimit.

ii. Pjesëmarrja e të rinjve

Procesi i vlerësimit duhet të plotësohet me përvojën e të rinjve. Pjesëmarrja e tyre nuk duhet të kufizohet vetëm në konsultimin që zhvillohet para krijimit ose përshtatjes së hapësirës, por duhet të vazhdojë edhe gjatë funksionimit të saj. Institucioni duhet të krijojë mundësi të përshtatshme që të rinjtë të shprehin mendimin e tyre për:

- mënyrën se si e përjetojnë sigurinë e hapësirës;
- pengesat që hasin gjatë përdorimit;
- mënyrën se si zbatohen rregullat;
- aksesueshmërinë dhe përfshirjen;
- privatësinë dhe ndjenjën e respektit;
- mënyrën se si funksionojnë mekanizmat e raportimit;
- ndryshimet që do ta bënin hapësirën më të sigurt.

Në varësi të natyrës së hapësirës, mund të përdoren diskutime të drejtpërdrejta, pyetësorë të shkurtër, konsultime individuale, forma anonime të marrjes së mendimeve, mjete digjitale, përmes të cilave të rinjtë identifikojnë zonat ose situatat që i konsiderojnë të sigurta, problematike ose që kërkojnë përmirësim.

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels
(EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)
Funded by the European Union

Aktorët përgjegjës, gjatë marrjes së mendimeve, duhet të përpiqen të mos mbështeten vetëm te të rinjtë që marrin pjesë rregullisht në aktivitetet e hapësirës. Kur është e mundur, duhet të krijohen mundësi për të dëgjuar edhe të rinjtë që mund të përballen me pengesa për pjesëmarrje, përfshirë të rinjtë me aftësi të kufizuara ose grupe të tjera që mund të kenë përvoja të ndryshme të sigurisë dhe aksesueshmërisë.

Pjesëmarrja duhet të jetë e kuptueshme, vullnetare dhe e përshtatshme për moshën dhe karakteristikat e të rinjve. Për çështje të ndjeshme duhet të ofrohen, kur është e nevojshme, mënyra të sigurta dhe konfidenciale për të shprehur shqetësimet.

iii. Nga gjetjet te masat për përmirësim

Rezultatet e vetëvlerësimit, mendimet e të rinjve dhe informacioni i mbledhur gjatë funksionimit të hapësirës duhet të përdoren për të përcaktuar nëse kërkohen masa të reja ose ndryshime në masat ekzistuese. Kur identifikohet një problem, aktorët përgjegjës duhet të përcaktojnë, sipas rastit:

- çfarë duhet të ndryshohet;
- çfarë mase duhet të ndërmerret;
- kush është përgjegjës për zbatimin;
- kur duhet të realizohet;
- çfarë burimesh nevojiten;
- si do të verifikohet rezultati.

Jo çdo gjetje kërkon ndërhyrje të menjëhershme ose të njëjtin nivel burimesh. Prioritet duhet t'u jepet çështjeve që lidhen me rreziqe të rëndësishme për sigurinë, mbrojtjen, aksesueshmërinë ose të drejtat e të rinjve. Kur një problem nuk mund të zgjidhet menjëherë, aktorët përgjegjës duhet të përcaktojnë, kur është e mundur, masa të përkohshme për reduktimin e rrezikut dhe të planifikojnë ndërhyrjen e nevojshme.

iv. Monitorimi dhe rishikimi

Monitorimi duhet të vlerësojë jo vetëm nëse masat e përcaktuara janë zbatuar, por edhe nëse ato kanë adresuar në mënyrë efektive rreziqet dhe nevojat e identifikuara. Në këtë proces, institucioni për të verifikuar nëse monitorimi është realizuar, mund të shqyrtojë:

- masat e përcaktuara janë zbatuar;
- rreziqet dhe mangësitë e identifikuara janë adresuar;
- rregullat dhe procedurat zbatohen dhe funksionojnë në praktikë;
- stafi dhe personat përgjegjës i njohin rolet dhe përgjegjësitë e tyre;
- të rinjtë dinë ku dhe si të kërkojnë ndihmë ose të raportojnë një shqetësim;
- mekanizmat e raportimit, reagimit dhe referimit funksionojnë në përputhje me procedurat e përcaktuara;

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels
(EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)
Funded by the European Union

- janë shfaqur rreziqe, pengesa ose nevoja të reja;
- të rinjtë e perceptojnë hapësirën si të sigurt, të aksesueshme dhe gjithëpërfshirëse.

Për të verifikuar nëse procesi i monitorimit funksionoi, ai mund të mbështetet në tregues të thjeshtë dhe të përshtatshëm për natyrën, madhësinë dhe funksionin e hapësirës. Këta mund të përfshijnë, ndër të tjera, shkallën e zbatimit të masave të planifikuara, shqetësimet e raportuara dhe mënyrën e trajtimit të tyre, pjesëmarrjen e të rinjve në proceset e konsultimit, gjetjet nga listat e kontrollit dhe ndryshimet ose masat përmirësuese të ndërmarra si rezultat i monitorimit.

Rishikimi duhet të kryhet në intervale të përshtatshme për natyrën e hapësirës dhe sa herë që ndodh një ndryshim i rëndësishëm, një incident, një ndryshim në mënyrën e përdorimit të hapësirës ose identifikohet një rrezik i ri. Pas rishikimit, aktorët përgjegjës duhet të përcaktojnë nëse masat ekzistuese do të vazhdojnë, do të përshtaten ose do të zëvendësohen. Kur është e nevojshme, procesi i vlerësimit dhe konsultimit me të rinjtë duhet të përsëritet.

v. Përmirësimi i vazhdueshëm

Përmirësimi i vazhdueshëm nënkupton që siguria e hapësirës trajtohet si një proces dinamik dhe jo si një gjendje që plotësohet vetëm në momentin e krijimit të saj. Gjetjet nga vetëvlerësimi, monitorimi dhe pjesëmarrja e të rinjve duhet të përdoren për të përditësuar masat e sigurisë dhe për të përshtatur mënyrën e funksionimit të hapësirës.

Në këtë proces, aktorët përgjegjës duhet të ruajnë një qasje proporcionale. Një ndryshim i vogël në përdorimin e hapësirës mund të kërkojë vetëm një përshtatje të thjeshtë të organizimit ose rregullave, ndërsa një ndryshim i rëndësishëm, një incident ose një rrezik i ri i identifikuar mund të kërkojë një vlerësim më të plotë dhe masa të reja.

Përmirësimi duhet të jetë i dukshëm edhe për të rinjtë. Kur ndërmerren ndryshime në bazë të gjetjeve të monitorimit, aktorët përgjegjës duhet t'i informojnë të rinjtë për ndryshimet e bëra. Kjo forcon besimin dhe tregon se pjesëmarrja e tyre ka një lidhje reale me mënyrën se si funksionon hapësira.

Në këtë mënyrë, cikli i përmirësimit të vazhdueshëm mbyllet dhe fillon përsëri. Ky cikël nuk kërkon domosdoshmërisht procese të ndërlikuara administrative. Ai duhet të përshtatet me madhësinë, funksionin dhe nivelin e rrezikut të hapësirës dhe të integrohet, sa më shumë të jetë e mundur, në mënyrën ekzistuese të administrimit dhe monitorimit të institucionit.

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels
(EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)
Funded by the European Union

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels
(EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)

Funded by the European Union

VI. REKOMANDIME PËR ZBATIM

Rekomandimet e mëposhtme synojnë të ndihmojnë institucionet dhe aktorët përgjegjës në përkthimin e parimeve dhe dimensioneve të sigurisë në masa konkrete për krijimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave të sigurta për të rinjtë.

Fusha	Rekomandimi	Çfarë duhet të sigurojë institucioni?	Instrument orientues në Udhëzues
Përgjegjësia institucionale	Përcaktoni përgjegjësitë	Role dhe përgjegjësi të qarta për sigurinë, mbrojtjen, aksesueshmërinë dhe funksionimin e hapësirës.	Aneksi nr. 8
Planifikimi	Përfshini sigurinë që në fillim	Siguria të merret në konsideratë gjatë krijimit, projektimit ose përshtatjes së hapësirës.	Kapitulli IV
Vlerësimi i rrezikut	Identifikoni rreziqet dhe nevojat	Vlerësim të kushteve fizike, organizative, të marrëdhënieve dhe sjelljes, aksesueshmërisë, privatësisë, sigurisë digjitale dhe mjedisit përreth.	Aneksi nr. 1 Aneksi nr.2
Aksesueshmëria dhe përfshirja	Reduktoni pengesat	Masa për aksesueshmëri, përfshirje dhe përshtatje të arsyeshme, sipas nevojës.	Aneksi nr. 2 Aneksi nr. 4
Pjesëmarrja e të rinjve	Merrni dhe shqyrtoni mendimet e të rinjve	Mënyra të përshtatshme për konsultim, marrjen e mendimeve dhe identifikim të shqetësimeve.	Aneksi nr. 5
Informimi	Informoni të rinjtë	Informacion të qartë për rregullat, personat përgjegjës, të drejtat, kërkimin e ndihmës dhe raportimin.	Aneksi nr. 7
Raportimi dhe reagimi	Siguroni mekanizma raportimi dhe referimi	Kanale të aksesueshme raportimi, procedura reagimi dhe referim te strukturat kompetente.	Aneksi nr. 4 Aneksi nr. 7

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels
(EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)

Funded by the European Union

Rregullat	Vendosni rregulla të qarta	Rregulla të përshtatura me natyrën e hapësirës dhe të komunikuara me përdoruesit.	Aneksi nr. 7
Stafi dhe personat përgjegjës	Përcaktoni rolet dhe kufijtë profesionalë	Personat e angazhuar të njohin rolin, përgjegjësitë, kufijtë e kompetencave dhe procedurat e raportimit/referimit.	Aneksi nr. 8
Trajnimi dhe orientimi	Trajnoni dhe orientoni stafin	Orientim fillestar dhe trajnim sipas rolit, përgjegjësive, rreziqeve dhe karakteristikave të hapësirës.	Aneksi nr. 8
Siguria e stafit	Mbroni sigurinë dhe mirëqenien e stafit	Masa për situata konfliktuale, incidente, emergjenca dhe raste që tejkalojnë kapacitetet e personave të angazhuar.	Aneksi nr. 8
Emergjencat	Përgatituni për situata emergjente	Masa, role dhe procedura të qarta për reagim në emergjenca.	Aneksi nr. 4 Aneksi nr. 8
Privatësia dhe të dhënat	Mbroni informacionin personal	Rregulla për trajtimin e të dhënave dhe njohjen e kufijve të konfidencialitetit.	Aneksi nr. 4 Aneksi nr. 8
Aktivitetet me rrezik të veçantë	Vlerësoni rreziqet para aktivitetit	Vlerësim të posaçëm dhe masa sigurie për aktivitetet me rrezik të veçantë	Kapitulli IV Aneksi nr. 3
Dokumentimi	Dokumentoni masat dhe përgjegjësitë	Masat, përgjegjësit, afatet dhe veprimet e ndërmarra të jenë të dokumentuara në mënyrë të përshtatshme	Aneksi nr. 3 Aneksi nr. 6
Monitorimi	Monitoroni zbatimin dhe efektivitetin	Kontroll periodik të zbatimit, shqetësimeve, marrjes së mendimeve dhe efektivitetit të masave.	Aneksi nr. 2 Aneksi nr. 4
Incidentet	Mësoni nga incidentet dhe shqetësimet	Vlerësim nëse incidenti evidenton dobësi në organizimin ose funksionimin e hapësirës.	Kapitulli V

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels (EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)

Funded by the European Union

Rishikimi dhe përmirësimi	Përditësoni masat	Ndryshime në rregulla, procedura, trajnim ose masa parandaluese kur është e nevojshme.	Aneksi 6
Përdorimi i instrumenteve	Përdorni mjetet e Udhëzuesit	Zgjedhjen dhe përdorimin proporcional të instrumenteve sipas natyrës dhe nivelit të rrezikut të hapësirës.	Të gjitha anekset

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels
(EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)

Funded by the European Union

MEKANIZMAT PRAKTIKË TË ZBATIMIT TË UDHËZUESIT

Anekset janë pjesë integrale e Udhëzuesit dhe synojnë të mbështesin zbatimin praktik të parimeve, procedurave dhe masave të përcaktuara në kapitujt përkatës. Ato mund të përshtaten nga institucionet, bashkitë, organizatat rinore dhe ofruesit e shërbimeve sipas madhësisë, funksionit dhe karakteristikave të hapësirës.

Mekanizmat nuk synojnë të zëvendësojnë kërkesat ligjore, procedurat institucionale ose formatet zyrtare që mund të kërkohen nga autoritetet kompetente. Ato shërbejnë si modele praktike për organizimin e punës së përditshme.

Aneksi Nr. 1 “Matrica e vetëvlerësimit të parimeve të hapësirës së sigurt për të rinjtë”;

Aneksi Nr.2 “Matrica e vetëvlerësimit të dimensioneve të sigurisë në hapësirën e sigurt për të rinjtë”;

Aneksi nr. 3 “Matrica për zbatimin e procesit të krijimit dhe menaxhimit të një hapësire të sigurt për të rinjtë”

Aneksi nr. 4 “Lista e kontrollit për krijimin dhe funksionimin e një hapësire të sigurt për të rinjtë”;

Aneksi nr. 5 “Mjetet për pjesëmarrjen dhe marrjen e mendimeve të të rinjve”;

Aneksi nr. 6 “Plan veprimi për krijimin dhe funksionimin e një hapësire të sigurt për të rinjtë”;

Aneksi nr. 7 “Model orientues i rregullave të hapësirës”;

Aneksi nr. 8 “Tabelë orientuese për stafin dhe personat përgjegjës për një hapësirë të sigurt për të rinjtë”.

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels
(EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)

Funded by the European Union

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels
(EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)

Funded by the European Union

ANEKS NR. 1 "MATRICA E VETËVLERËSIMIT TË PARIMEVE TË HAPËSIRËS SË SIGURT PËR TË RINJTË"

Aneksi i shërben aktorëve përgjegjës për të vlerësuar shkallën në të cilën parimet e hapësirës së sigurt për të rinjtë janë të integruara në organizimin, funksionimin dhe menaxhimin e hapësirës. Ai mund të përdoret gjatë vetëvlerësimit periodik, planifikimit të masave për përmirësim dhe monitorimit të progresit.

Nr.	Parimi	Pyetje/kritere kontrolli	Po	Pjesërisht	Jo	Nuk aplikohet	Evidenca / Komente	Masa për përmirësim
1	**Respekti për të drejtat dhe dinjitetin**	A trajtohen të rinjtë me respekt dhe dinjitet në të gjitha ndërveprimet me stafin, vullnetarët dhe personat e tjerë të përfshirë?	☐	☐	☐	☐		
		A janë të ndaluara dhe parandaluara sjelljet poshtëruese, kërcënuese, denigruese ose presioni ndaj të rinjve?	☐	☐	☐	☐		
		A kanë stafi dhe vullnetarët udhëzime ose rregulla të qarta për komunikimin dhe sjelljen respektuese ndaj të rinjve?	☐	☐	☐	☐		
2	**Mosdiskriminimi dhe trajtimi i barabartë**	A ofrohen mundësi të barabarta pjesëmarrjeje për të gjithë të rinjtë, pa diskriminim?	☐	☐	☐	☐		
		A ekzistojnë masa për parandalimin dhe adresimin e bullizmit, ngacmimit, diskriminimit dhe përjashtimit?	☐	☐	☐	☐		
		A identifikohen rastet kur trajtimi i barabartë kërkon masa mbështetëse ose përshtatje të arsyeshme?	☐	☐	☐	☐		
3	**Gjithëpërfshirja dhe aksesueshmëria**	A është hapësira fizikisht e aksesueshme për të rinjtë me aftësi të kufizuara dhe me nevoja të ndryshme?	☐	☐	☐	☐		
		A është informacioni i aksesueshëm dhe i kuptueshëm për të rinjtë me nevoja të ndryshme?	☐	☐	☐	☐		
		A merren masa për të reduktuar pengesat në komunikim, teknologji, aktivitete dhe pjesëmarrje?	☐	☐	☐	☐		

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels (EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)

Funded by the European Union

		A identifikohen nevojat e grupeve të ndryshme të të rinjve gjatë planifikimit të aktiviteteve dhe shërbimeve?	☐	☐	☐	☐		
4	**Mbrojtja dhe parandalimi i dëmit**	A ekzistojnë masa për parandalimin e dhunës, abuzimit, ngacmimit, bullizmit, kërcënimeve dhe formave të tjera të sjelljes së dëmshme?	☐	☐	☐	☐		
		A janë të përcaktuara mënyrat për identifikimin dhe raportimin e shqetësimeve ose incidenteve?	☐	☐	☐	☐		
		A dinë të rinjtë se ku dhe te kush mund të kërkojnë ndihmë ose të raportojnë një shqetësim?	☐	☐	☐	☐		
		A ekzistojnë procedura për referimin e rasteve te strukturat ose shërbimet kompetente?	☐	☐	☐	☐		
5	**Privatësia dhe konfidencialiteti**	A trajtohen të dhënat personale të të rinjve në mënyrë të sigurt dhe në përputhje me kërkesat ligjore?	☐	☐	☐	☐		
		A janë të përcaktuara personat që kanë të drejtë të aksesojnë informacionet personale?	☐	☐	☐	☐		
		Informohen të rinjtë për mënyrën e përdorimit dhe ruajtjes së të dhënave të tyre?	☐	☐	☐	☐		
		A merren masa për ruajtjen e konfidencialitetit gjatë komunikimit dhe trajtimit të rasteve individuale?	☐	☐	☐	☐		
6	**Pjesëmarrja e të rinjve**	A përfshihen të rinjtë në krijimin, zhvillimin dhe përmirësimin e hapësirës?	☐	☐	☐	☐		
		A kanë të rinjtë mundësi të shprehin mendimet, të identifikojnë rreziqe dhe pengesa dhe të propozojnë përmirësime?	☐	☐	☐	☐		
		A përdoren mekanizma të përshtatshëm për konsultimin dhe mbledhjen e mendimeve të të rinjve?	☐	☐	☐	☐		

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels
(EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)
Funded by the European Union

		A u komunikohet të rinjve se si është marrë në konsideratë kontributi i tyre dhe çfarë masash janë ndërmarrë?	☐	☐	☐	☐		
7	**Përgjegjshmëria dhe transparenca**	A është e qartë se kush është përgjegjës për sigurinë dhe mirëqenien e të rinjve në hapësirë?	☐	☐	☐	☐		
		A janë të qarta mënyrat për raportimin e një shqetësimi dhe hapat që ndiqen pas raportimit?	☐	☐	☐	☐		
		A janë rregullat e përdorimit të hapësirës dhe mekanizmat e ndihmës të aksesueshëm për të rinjtë?	☐	☐	☐	☐		
		A dokumentohen, trajtohen dhe monitorohen shqetësimet e identifikuara?	☐	☐	☐	☐		

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels
(EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)
Funded by the European Union

ANEKSI NR. 2 "MATRICA E VETËVLERËSIMIT TË DIMENSIONEVE TË SIGURISË NË HAPËSIRËN E SIGURT PËR TË RINJTË"

Aneksi i shërben institucionit për të kontrolluar dhe vlerësuar masat e marra për garantimin e sigurisë së të rinjve në dimensionet fizike, psikologjike dhe emocionale, mbrojtjen nga dhuna dhe format e tjera të dëmit, mosdiskriminimin dhe aksesueshmërinë, privatësinë dhe konfidencialitetin, sigurinë në mjedisin digjital, sigurinë gjatë aktiviteteve jashtë hapësirës dhe gatishmërinë për emergjenca. Ai mund të përdoret për vetëvlerësim periodik, identifikimin e rreziqeve dhe boshllëqeve, si dhe planifikimin e masave për përmirësim.

Nr.	Dimensioni i sigurisë	Pyetje/kriter kontrolli	Po	Pjesërisht	Jo	Nuk aplikohet	Evidenca / Komente	Masa për përmirësim
1	**Siguria fizike dhe kushtet e ambientit**	A kontrollohet periodikisht gjendja e ambienteve dhe pajisjeve për identifikimin e rreziqeve të mundshme?						
		A janë hyrjet dhe daljet të sigurta dhe të përshtatshme për përdoruesit e hapësirës?						
		A është ndriçimi i përshtatshëm në ambientet e brendshme dhe të jashtme, sipas natyrës së hapësirës?						
		A janë kushtet e ajrimit dhe higjieno-sanitare të përshtatshme?						
		A janë pajisjet dhe mjetet e përdorura në hapësirë në gjendje të sigurt dhe të mirëmbajtur?						
		A janë identifikuar dhe adresuar rreziqet fizike të evidentuara?						
		Kur një rrezik nuk mund të eliminohet menjëherë, a kufizohet përdorimi i ambientit ose pajisjes deri në marrjen e masave?						

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels (EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)

Funded by the European Union

2	**Siguria psikologjike dhe emocionale**	A ekzistojnë rregulla të qarta për sjelljen, respektin dhe ndërveprimin në hapësirë?						
		A mund të shprehen të rinjtë pa frikën e poshtërimit, kërcënimit, përjashtimit ose ndëshkimit të padrejtë?						
		A ekzistojnë mënyra të përshtatshme për të rinjtë për të shprehur shqetësime ose për të kërkuar ndihmë?						
		A ekzistojnë mënyra të përshtatshme për parandalimin dhe menaxhimin e konflikteve, frikësimit dhe përjashtimit?						
		A janë të qarta kufijtë e rolit të stafit dhe personave të tjerë kur një i ri ka nevojë për mbështetje të specializuar?						
		A ekzistojnë mekanizma të përshtatshëm për referimin te shërbimet ose strukturat kompetente?						
3	**Mbrojtja nga dhuna, abuzimi, ngacmimi dhe shfrytëzimi**	A ekzistojnë masa parandaluese për dhunën, abuzimin, ngacmimin, bullizmin, kërcënimet dhe shfrytëzimin?						
		A janë të përcaktuar personat përgjegjës për marrjen dhe trajtimin e shqetësimeve?						
		A ekziston një mekanizëm i qartë dhe i aksesueshëm për raportimin e shqetësimeve?						
		Informohen të rinjtë për mënyrat e kërkimit të ndihmës dhe raportimit?						
		A ekzistojnë procedura për referimin e rasteve te strukturat kompetente?						
		Kur hapësira përdoret nga persona nën 18 vjeç, a përfshihen kërkesat specifike për mbrojtjen e fëmijës?						
4	**Mosdiskriminimi, gjithëpërfshirja dhe aksesueshmëria**	A janë identifikuar pengesat fizike që mund të pengojnë përdorimin e hapësirës?						

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels (EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)
Funded by the European Union

		A janë identifikuar pengesat në komunikim dhe aksesin në informacion?						
		A janë marrë masa për aksesueshmërinë e teknologjisë dhe mjeteve digjitale?						
		A analizohen pengesat ekonomike, organizative ose të tjera që mund të kufizojnë pjesëmarrjen?						
		A janë parashikuar përshtatje të arsyeshme kur nevojiten?						
		A përfshihen të rinjtë që përballen me pengesa në identifikimin e tyre dhe diskutimin e zgjidhjeve?						
5	**Privatësia dhe konfidencialiteti**	A është përcaktuar se çfarë të dhënash dhe informacioni personal mblidhen dhe për çfarë qëllimi?						
		A është e qartë se kush ka akses në të dhënat dhe informacionet personale?						
		A ruhen të dhënat dhe informacionet personale në mënyrë të sigurt?						
		A respektohet privatësia gjatë komunikimit dhe ofrimit të mbështetjes?						
		A ekzistojnë rregulla për trajtimin e informacionit të ndjeshëm dhe kufizimin e ndarjes së tij?						
		A merren parasysh detyrimet ligjore për raportim ose mbrojtjen e personave kur konfidencialiteti nuk mund të zbatohet në mënyrë absolute?						
6	**Siguria në mjedisin digjital**	A janë përcaktuar rregulla për përdorimin e sigurt të platformave online, grupeve të komunikimit dhe rrjeteve sociale?						
		A merren masa për mbrojtjen e të dhënave dhe sigurinë e llogarive dhe pajisjeve?						
		A janë të përcaktuara rregulla për publikimin e fotografive, videove dhe						

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels
(EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)
Funded by the European Union

		përmbajtjeve të tjera që lidhen me të rinjtë?						
		A ekzistojnë mënyra për identifikimin dhe trajtimin e komunikimeve ose përmbajtjeve të papërshtatshme?						
		Informohen të rinjtë për mënyrat e raportimit të shqetësimeve në mjedisin digjital?						
7	**Siguria gjatë aktiviteteve jashtë hapësirës**	A kryhet vlerësimi i rreziqeve përpara zhvillimit të aktiviteteve jashtë hapësirës së përhershme?						
		A vlerësohen vendndodhja, itinerari, transporti dhe kohëzgjatja e aktivitetit?						
		A merren parasysh kushtet e ambientit dhe nevojat e veçanta të pjesëmarrësve?						
		A janë përcaktuar përgjegjësitë dhe kontaktet përpara aktivitetit?						
		A janë përcaktuar masat për reagimin ndaj incidenteve ose emergjencave gjatë aktivitetit?						
8	**Gatishmëria për emergjenca**	A janë identifikuar rreziqet dhe situatat kryesore të emergjencës që mund të prekin hapësirën?						
		A janë përcaktuar qartë përgjegjësitë në rast emergjence?						
		A janë të përcaktuara dhe të aksesueshme rrugët e evakuimit dhe pikat e grumbullimit?						
		A janë të disponueshme dhe të përditësuara kontaktet e emergjencës?						
		A analizohet mbështetja që mund t'u nevojitet personave gjatë evakuimit ose në situata emergjente?						
		A njihen procedurat e emergjencës nga stafi dhe nga të rinjtë që përdorin hapësirën?						

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels
(EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)
Funded by the European Union

		A kryhen periodikisht ushtrime, testime ose rishikime të procedurave të emergjencës, sipas natyrës së hapësirës?						

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels
(EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)
Funded by the European Union

ANEKSI NR. 3 "MATRICA PËR ZBATIMIN E PROCESIT TË KRIJIMIT DHE MENAXHIMIT TË NJË HAPËSIRE TË SIGURT PËR TË RINJTË"

Ky Aneks synon t'u ofrojë institucioneve një instrument praktik për planifikimin dhe zbatimin hap pas hapi të procesit të krijimit, vlerësimit dhe përmirësimit të një hapësire të sigurt për të rinjtë. Ai mund të përdoret si për krijimin e një hapësire të re, ashtu edhe për vlerësimin dhe përmirësimin e një hapësire ekzistuese.

Etapa	Çfarë duhet të bëjë institucioni?	Si mund të realizohet?	Kush duhet të përfshihet?	Çfarë duhet të dokumentohet?	Rezultati i pritshëm
1. Përcaktimi i hapësirës dhe qëllimit	Të përcaktojë hapësirën që do të vlerësohet ose krijohet, funksionin e saj dhe grupet e të rinjve që do ta përdorin.	Të përcaktohet lloji i hapësirës, aktivitetet që do të zhvillohen, oraret e përdorimit dhe profili i përdoruesve.	Institucioni/struktura përgjegjëse; stafi; sipas rastit, organizatat rinore dhe të rinjtë.	Përshkrimi i hapësirës; qëllimi; aktivitetet; grupet e synuara.	Përcaktim i qartë i hapësirës dhe përdoruesve të saj.
2. Përcaktimi i përgjegjësive	Të përcaktojë personat përgjegjës për koordinimin e procesit.	Të caktohet një person ose grup pune dhe të përcaktohen përgjegjësitë.	Personat përgjegjës për administrimin e hapësirës; stafi përkatës; sipas nevojës, ekspertë ose shërbime të specializuara.	Vendimi/urdhri i brendshëm ose dokumenti i përcaktimit të përgjegjësive.	Përgjegjësi të qarta për procesin.
3. Vlerësimi fillestar i hapësirës	Të shqyrtojë kushtet dhe karakteristikat e hapësirës përpara se të përcaktojë masat e sigurisë.	Të kryhet një vëzhgim sistematik i ambienteve, hyrjeve/daljeve, ndriçimit, shkallëve, korridoreve, higjienës, pajisjeve, mobilimit, aksesueshmërisë, privatësisë dhe zonës përreth.	Grupi përgjegjës; stafi; sipas nevojës, specialistë teknikë ose të tjerë.	Formulari/lista e kontrollit; fotografi kur është e përshtatshme; shënime dhe gjetje.	Pasqyrë e gjendjes fillestare dhe problematikave të evidentuara.
4. Identifikimi i rreziqeve	Të identifikojë rreziqet që mund të cenojnë sigurinë dhe mirëqenien e të rinjve.	Të shqyrtohen rreziqet fizike, psikologjike, sociale, të diskriminimit, bullizmit, dhunës, abuzimit, ngacmimit, privatësisë dhe sigurisë digjitale. Për aktivitetet jashtë hapësirës të vlerësohen edhe transporti dhe vendndodhja.	Grupi përgjegjës; stafi; të rinjtë; sipas nevojës, specialistë.	Regjistër/matricë e rreziqeve; përshkrimi i rrezikut dhe masat ekzistuese.	Identifikim i qartë i rreziqeve dhe prioriteteve.

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels (EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)

Funded by the European Union

5. Vlerësimi i nivelit të rrezikut	Të përcaktojë cilat rreziqe kërkojnë ndërhyrje prioritare.	Për çdo rrezik të shqyrtohet mundësia e ndodhjes dhe ndikimi i mundshëm dhe të përcaktohet prioriteti i ndërhyrjes.	Grupi përgjegjës; stafi; specialistë sipas natyrës së rrezikut.	Matrica e rrezikut; klasifikimi i prioriteteve.	Rreziqet e prioritizuara dhe të renditura për ndërhyrje.
6. Konsultimi me të rinjtë	Të përfshijë të rinjtë në identifikimin e rreziqeve, pengesave dhe zgjidhjeve.	Të përdoren takime, diskutime në grup, pyetësorë, intervista, harta të hapësirës, konsultime online ose metoda të tjera të përshtatshme.	Të rinjtë që përdorin ose do të përdorin hapësirën; organizata rinore; struktura rinore; sipas rastit, grupe që përballen me pengesa të veçanta.	Pyetësorë; procesverbale; përmbledhje e konsultimit; propozimet e të rinjve.	Identifikim i perspektivës së të rinjve dhe masave të propozuara prej tyre.
7. Identifikimi i masave	Të përcaktojë çfarë duhet bërë për të parandaluar ose reduktuar rreziqet e identifikuara.	Masat të ndahen, sipas nevojës, në masa, organizative, teknike/strukturore dhe sipas kohëzgjatjes, të menjëhershme, afatshkurtra, afatmesme ose afatgjata.	Institucioni; stafi; personat përgjegjës për buxhetin/infrastrukturën; të rinjtë sipas rastit.	Lista e masave; prioriteti; burimet e nevojshme.	Paketë konkrete masash për krijimin ose përmirësimin e sigurisë.
8. Hartimi i planit të masave	Të kthejë masat e identifikuara në një plan të zbatueshëm.	Për çdo masë të përcaktohet veprimi, përgjegjësi, afati, burimi dhe mënyra e verifikimit.	Institucioni dhe strukturat përgjegjëse.	Plan masash i miratuar/përcaktuar nga institucioni.	Plan i qartë dhe i zbatueshëm.
9. Përcaktimi i rregullave të funksionimit	Të përcaktojë rregullat për përdorimin e sigurt të hapësirës.	Të përcaktohen sjelljet e pritshme, përdorimi i ambienteve dhe pajisjeve, përgjegjësitë dhe mënyra e trajtimit të situatave shqetësuese.	Administratori i hapësirës; stafi; të rinjtë, sipas rastit.	Rregullorja/rregullat e përdorimit; udhëzimet për stafin.	Rregulla të qarta, të kuptueshme dhe të aksesueshme.
10. Përcaktimi i mekanizmave të raportimit dhe referimit	Të krijojë mënyra të qarta dhe të aksesueshme për raportimin e shqetësimeve.	Të përcaktohet kujt i raportohet, si regjistrohet shqetësimi, si trajtohet dhe kur referohet te një strukturë tjetër kompetente.	Personat përgjegjës; stafi; shërbimet/strukturat kompetente.	Procedura e raportimit dhe referimit; kontaktet përkatëse.	Mekanizëm funksional dhe i kuptueshëm raportimi.
11. Zhvillimi i kapaciteteve të stafit	Të sigurojë që personat që punojnë në hapësirë të dinë rolin dhe përgjegjësitë e tyre.	Orientim fillestar, udhëzime praktike, trajnime ose aktivitete të tjera sipas nevojës.	Stafi dhe personat që kanë kontakt me të rinjtë.	Materialet e orientimit/trajnimit; evidenca e pjesëmarrjes.	Staf i informuar dhe i përgatitur për zbatimin e masave.

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels (EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)

Funded by the European Union

12. Informimi i të rinjve	Të informojë të rinjtë për mënyrën e funksionimit dhe mekanizmat e sigurisë.	Informacion i afishuar, materiale informuese, orientim në momentin e përdorimit, kanale online ose forma të tjera të përshtatshme.	Të gjithë përdoruesit e rinj të hapësirës.	Materialet e informimit; rregullat; informacioni për raportimin dhe ndihmën.	Të rinj të informuar për të drejtat, rregullat dhe mënyrat e kërkimit të ndihmës.
13. Zbatimi i masave	Të zbatojë masat e përcaktuara në plan.	Të realizohen ndërhyrjet fizike, organizative, procedurale ose të tjera sipas prioriteteve dhe afateve.	Personat/strukturat përgjegjëse për secilën masë.	Evidenca e zbatimit; raporte; dokumente; fotografi kur është e përshtatshme.	Masat e sigurisë të vendosura në praktikë.
14. Marrja e mendimeve	Të mbledhë në mënyrë periodike mendimet e të rinjve për sigurinë dhe funksionimin e hapësirës.	Pyetësorë të shkurtër, takime, kuti sugjerimesh, konsultime ose mjete digjitale.	Të rinjtë dhe përdoruesit e hapësirës.	Rezultatet e marrjes së mendimeve; sugjerimet; shqetësimet e identifikuara.	Evidencë mbi përvojën e përdoruesve dhe nevojat për përmirësim.
15. Monitorimi	Të kontrollojë nëse masat funksionojnë në praktikë.	Vëzhgim i hapësirës, shqyrtim i incidenteve dhe raportimeve, komunikim me stafin dhe të rinjtë dhe verifikim i zbatimit të planit.	Institucioni; personat përgjegjës; sipas rastit, të rinjtë.	Raport/rekord monitorimi; gjetje dhe rekomandime.	Evidencë mbi funksionimin real të masave.
16. Rishikimi dhe përmirësimi	Të rishikojë procesin dhe të përshtatë masat kur ndryshojnë rreziqet ose nevojat.	Të rishikohet vlerësimi i rrezikut, marrja e mendimeve dhe zbatimi i masave dhe të përditësohet plani.	Institucioni; stafi; të rinjtë sipas rastit.	Vlerësimi i përditësuar; plan i rishikuar masash.	Proces i vazhdueshëm përmirësimi dhe përshtatjeje.

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels
(EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)

Funded by the European Union

ANEKSI NR. 4 "LISTA E KONTROLLIT PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E NJË HAPËSIRE TË SIGURT PËR TË RINJTË"

Ky Aneks është një instrument praktik që ndihmon institucionet dhe ofruesit e hapësirave për të rinjtë të verifikojnë nëse elementet kryesore të sigurisë, mbrojtjes, përfshirjes, aksesueshmërisë dhe pjesëmarrjes janë përfshirë dhe zbatohen në praktikë. Lista mund të përdoret për një hapësirë ekzistuese, gjatë përshtatjes së një hapësire, si dhe në fazën e planifikimit të një hapësire të re. Ajo mund të përdoret edhe në kuadër të monitorimit periodik dhe të planifikimit të masave për përmirësim.

A. Planifikimi dhe përdoruesit

Nr.	Elementi	Çfarë duhet të verifikohet	Po	Pjesërisht	Jo	Dëshmi / çfarë u verifikua	Masë / veprim i nevojshëm
1	Nevojat e të rinjve	Janë identifikuar nevojat, aktivitetet dhe mënyrat e përdorimit të hapësirës nga të rinjtë.					
2	Grupet e përdoruesve	Janë përfshirë grupet e ndryshme të të rinjve dhe nevojat e tyre.					
3	Pengesat	Janë identifikuar pengesat që mund të kufizojnë aksesin ose pjesëmarrjen.					
4	Përfshirja e të rinjve	Të rinjtë kanë pasur mundësi të shprehin nevojat dhe pritshmëritë e tyre lidhur me hapësirën.					

B. Siguria fizike dhe kushtet e hapësirës

Nr.	Elementi	Çfarë duhet të verifikohet	Po	Pjesërisht	Jo	Dëshmi / çfarë u verifikua	Masë / veprim i nevojshëm
5	Vendndodhja	Vendndodhja është e përshtatshme dhe e arritshme për përdoruesit.					
6	Hyrjet dhe daljet	Hyrjet dhe daljet janë të qarta, të përdorshme dhe të përshtatshme për evakuim.					
7	Ndriçimi	Hapësirat kryesore dhe zonat e hyrje-daljeve kanë ndriçim të përshtatshëm.					

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels (EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)

Funded by the European Union

8	Lëvizja dhe organizimi	Organizimi i mobilieve dhe pajisjeve lejon lëvizje dhe përdorim të sigurt.					
9	Gjendja e hapësirës	Ambientet, mobiliet dhe pajisjet janë në gjendje të përshtatshme dhe nuk paraqesin rreziqe që mund të parandalohen ose eliminohen.					
10	Higjiena dhe kushtet	Kushtet e higjienës, ventilimit dhe mirëmbajtjes janë të përshtatshme për përdorimin e hapësirës.					
11	Emergjencat	Ka masa dhe informacion të përshtatshëm për situatat emergjente, përfshirë rrugët e evakuimit dhe pikat e grumbullimit.					

C. Aksesueshmëria dhe përfshirja

Nr.	Elementi	Çfarë duhet të verifikohet	Po	Pjesërisht	Jo	Dëshmi / çfarë u verifikua	Masë / veprim i nevojshëm
12	Aksesueshmëria fizike	Hapësira mund të përdoret nga persona me aftësi të kufizuara, në përputhje me kërkesat e zbatueshme.					
13	Aksesueshmëria e informacionit	Informacioni dhe udhëzimet janë të kuptueshme dhe, kur nevojitet, të përshtatura për përdorues të ndryshëm.					
14	Përshtatja e arsyeshme	Kur identifikohen pengesat, janë marrë masat e nevojshme për përshtatje të arsyeshme.					
15	Mosdiskriminimi	Rregullat dhe praktikat e hapësirës parandalojnë diskriminimin, përjashtimin, ngacmimin dhe bullizmin.					

D. Privatësia dhe siguria digjitale

Nr.	Elementi	Çfarë duhet të verifikohet	Po	Pjesërisht	Jo	Dëshmi / çfarë u verifikua	Masë / veprim i nevojshëm
16	Privatësia	Ka mundësi për ruajtjen e privatësisë kur aktiviteti ose situata e kërkon.					
17	Të dhënat personale	Të dhënat personale mblidhen, përdoren, ruhen dhe aksesohen në përputhje me kërkesat ligjore.					
18	Informimi mbi të dhënat	Të rinjtë informohen, sipas rastit, për mënyrën e përdorimit dhe përpunimit të të dhënave të tyre.					
19	Siguria digjitale	Janë marrë masa për përdorimin e sigurt të pajisjeve, platformave dhe kanaleve digjitale që lidhen me hapësirën.					
20	Foto dhe video	Ekzistojnë praktika të përshtatshme për fotografimin, filmimin dhe publikimin e materialeve që identifikojnë të rinjtë.					

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels (EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)
Funded by the European Union

E. Mbrojtja, raportimi dhe reagimi

Nr.	Elementi	Çfarë duhet të verifikohet	Po	Pjesërisht	Jo	Dëshmi / çfarë u verifikua	Masë / veprim i nevojshëm
21	Personi përgjegjës	Është përcaktuar personi ose struktura përgjegjëse për çështjet e sigurisë dhe mbrojtjes.					
22	Rregullat e sjelljes	Janë përcaktuar dhe komunikuar rregulla të qarta për sjelljen dhe respektin reciprok.					
23	Raportimi	Të rinjtë dinë se ku dhe si mund të raportojnë një shqetësim ose incident.					
24	Reagimi	Ekziston një procedurë e përcaktuar për marrjen, trajtimin dhe dokumentimin e shqetësimeve.					
25	Referimi	Ekzistojnë mekanizma për referimin e rasteve te strukturat ose shërbimet kompetente, kur kjo kërkohet.					
26	Konfidencialiteti	Shqetësimet dhe informacioni përkatës trajtohen me konfidencialitet, duke respektuar detyrimet ligjore për mbrojtjen dhe raportimin.					
27	Përgatitja e stafit	Personat përgjegjës kanë njohuritë dhe orientimin e nevojshëm për identifikimin, raportimin dhe reagimin ndaj shqetësimeve.					

F. Informimi dhe pjesëmarrja e të rinjve

Nr.	Elementi	Çfarë duhet të verifikohet	Po	Pjesërisht	Jo	Dëshmi / çfarë u verifikua	Masë / veprim i nevojshëm
28	Informimi	Të rinjtë informohen për mënyrën e funksionimit të hapësirës, rregullat dhe personat përgjegjës.					
29	Mekanizmat e ndihmës	Informacioni për raportimin, kërkimin e ndihmës dhe referimin është i aksesueshëm dhe i kuptueshëm.					
30	Pjesëmarrja	Të rinjtë kanë mundësi të japin mendime dhe propozime për sigurinë dhe funksionimin e hapësirës.					
31	Marrja e mendimeve	Ekziston të paktën një mekanizëm i rregullt për mbledhjen e mendimeve nga të rinjtë.					
32	Përfshirja e mendimeve	Mendimi i të rinjve përfshihet në përmirësimin e hapësirës dhe masave të sigurisë.					

G. Monitorimi, rreziku dhe përmirësimi

Nr.	Elementi	Çfarë duhet të verifikohet	Po	Pjesërisht	Jo	Dëshmi / çfarë u verifikua	Masë / veprim i nevojshëm

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels
(EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)

Funded by the European Union

33	Identifikimi i rreziqeve	Rreziqet kryesore që lidhen me hapësirën dhe aktivitetet e saj janë identifikuar.					
34	Vlerësimi i rrezikut	Rreziqet janë vlerësuar duke marrë parasysh mundësinë e ndodhjes dhe ndikimin e tyre.					
35	Masat për reduktimin e rrezikut	Për rreziqet e identifikuara janë përcaktuar dhe, sipas rastit, zbatuar masa konkrete.					
36	Monitorimi periodik	Hapësira dhe masat e sigurisë monitorohen në mënyrë periodike.					
37	Rishikimi	Rezultatet e monitorimit dhe marrjes së mendimeve të të rinjve përdoren për të identifikuar nevoja të reja ose masa për përmirësim.					
38	Plani i përmirësimit	Çështjet që kërkojnë ndërhyrje janë pasqyruar në një plan masash me përgjegjësi dhe afate, sipas nevojës.					

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels
(EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)
Funded by the European Union

ANEKSI NR. 5 "MJETET PËR PJESËMARRJEN DHE MARRJEN E MENDIMEVE TË TË RINJVE"

A. Pyetësor i shkurtër për përvojën e të rinjve

A ndihesh i/e sigurt në këtë hapësirë?

☐ Gjithmonë

☐ Shpesh

☐ Ndonjëherë

☐ Rrallë

☐ Asnjëherë

A ndihesh i/e respektuar nga personat që punojnë ose angazhohen në hapësirë?

☐ Po

☐ Pjesërisht

☐ Jo

A e di ku mund të drejtohesh nëse ke një problem ose shqetësim?

☐ Po

☐ Pjesërisht

☐ Jo

A e ke të lehtë të përdorësh të gjitha hapësirat që të nevojiten?

☐ Po

☐ Pjesërisht

☐ Jo

A ka vende ose situata në këtë hapësirë ku nuk ndihesh rehat ose i/e sigurt?

☐ Jo

☐ Po

Nëse po, cilat? _____

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels
(EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)
Funded by the European Union

A mendon se rregullat e hapësirës janë të qarta dhe të drejta?

☐ Po

☐ Pjesërisht

☐ Jo

A ke mundësi të japësh mendimin tënd për mënyrën se si funksionon hapësira?

☐ Po

☐ Pjesërisht

☐ Jo

Çfarë do të ndryshoje për ta bërë këtë hapësirë më të sigurt ose më të përshtatshme për të rinjtë?

A ka ndonjë shqetësim tjetër që dëshiron të ndash?

Të rinjtë mund të përdorin një plan të thjeshtë të hapësirës dhe të shënojnë:

🟢 E gjelbër – ndihem i/e sigurt dhe rehat;

🟡 E verdhë – ka diçka që duhet përmirësuar;

🔴 E kuqe – identifikoj një problem ose rrezik.

Mund të vlerësohen, ndër të tjera:

- hyrja;
- korridoret;
- ambientet e përbashkëta;
- ambientet e punës;
- ambientet për aktivitete;
- ambientet e jashtme;
- tualetet;
- zonat me më pak vizibilitet;
- hapësirat ku kërkohet privatësi.

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels
(EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)
Funded by the European Union

Rezultatet duhet të diskutohen me të rinjtë dhe të përdoren si një nga burimet për përcaktimin dhe planifikimin e masave.

C. Pyetje për diskutim me të rinjtë

Çfarë e bën këtë hapësirë të sigurt për ty?

Çfarë të bën të ndihesh jo rehat?

A ka dikush që nuk mund ta përdorë hapësirën lehtësisht? Pse?

Çfarë duhet të ndryshojë?

A ndihesh se zëri yt merret në konsideratë?

Si do të preferoje të raportosh një problem?

Çfarë informacioni të mungon?

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels
(EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)
Funded by the European Union

ANEKSI NR. 6 "PLAN VEPRIMI PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E NJË HAPËSIRE TË SIGURT PËR TË RINJTË"

Aneksi përdoret pas kryerjes së vlerësimit të hapësirës dhe konsultimit me të rinjtë, për të përkthyer gjetjet në masa konkrete për përmirësimin e sigurisë, mbrojtjes, aksesueshmërisë, përfshirjes dhe pjesëmarrjes.

Plani i veprimit mund të përdoret si për hapësira ekzistuese, ashtu edhe gjatë planifikimit ose përshtatjes së një hapësire të re.

Tabela e planit të veprimit

Nr.	Fusha	Problemi / rreziku i identifikuar	Masa që duhet ndërmarrë	Lloji i masës	Prioriteti i masës	Përgjegjësi	Burimet e nevojshme	Afati	Si do të verifikohet zbatimi	Statusi
1				☐ Fizike/teknike ☐ Organizative ☐ Procedurale ☐ Informim/komunikim ☐ Trajnim/kapacitete ☐ Digjitale ☐ Investim ☐ Tjetër	☐ I lartë ☐ I mesëm ☐ I ulët			☐ I menjëhershëm ☐ Afatshkurtër ☐ Afatmesëm ☐ Afatgjatë		☐ Pa filluar ☐ Në zbatim ☐ Përfunduar
2				☐ Fizike/teknike ☐ Organizative ☐ Procedurale ☐ Informim/komunikim ☐ Trajnim/kapacitete ☐ Digjitale ☐ Investim ☐ Tjetër	☐ I lartë ☐ I mesëm ☐ I ulët			☐ I menjëhershëm ☐ Afatshkurtër ☐ Afatmesëm ☐ Afatgjatë		☐ Pa filluar ☐ Në zbatim ☐ Përfunduar
3				☐ Fizike/teknike ☐ Organizative ☐ Procedurale ☐ Informim/komunikim ☐ Trajnim/kapacitete	☐ I lartë ☐ I mesëm ☐ I ulët			☐ I menjëhershëm ☐ Afatshkurtër ☐ Afatmesëm ☐ Afatgjatë		☐ Pa filluar ☐ Në zbatim ☐ Përfunduar

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels (EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)

Funded by the European Union

				☐ Digjitale ☐ Investim ☐ Tjetër						
4				☐ Fizike/teknike ☐ Organizative ☐ Procedurale ☐ Informim/komunikim ☐ Trajnim/kapacitete ☐ Digjitale ☐ Investim ☐ Tjetër	☐ I lartë ☐ I mesëm ☐ I ulët			☐ I menjëhershëm ☐ Afatshkurtër ☐ Afatmesëm ☐ Afatgjatë		☐ Pa filluar ☐ Në zbatim ☐ Përfunduar
5				☐ Fizike/teknike ☐ Organizative ☐ Procedurale ☐ Informim/komunikim ☐ Trajnim/kapacitete ☐ Digjitale ☐ Investim ☐ Tjetër	☐ I lartë ☐ I mesëm ☐ I ulët			☐ I menjëhershëm ☐ Afatshkurtër ☐ Afatmesëm ☐ Afatgjatë		☐ Pa filluar ☐ Në zbatim ☐ Përfunduar
6				☐ Fizike/teknike ☐ Organizative ☐ Procedurale ☐ Informim/komunikim ☐ Trajnim/kapacitete ☐ Digjitale ☐ Investim ☐ Tjetër	☐ I lartë ☐ I mesëm ☐ I ulët			☐ I menjëhershëm ☐ Afatshkurtër ☐ Afatmesëm ☐ Afatgjatë		☐ Pa filluar ☐ Në zbatim ☐ Përfunduar

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels
(EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)
Funded by the European Union

ANEKSI NR. 7 "MODEL ORIENTUES I RREGULLAVE TË HAPËSIRËS"

Aneksi mund të përshtatet nga aktorët përgjegjës sipas natyrës, funksionit, përdoruesve dhe mënyrës së organizimit të hapësirës. Rregullat duhet të jenë të qarta, të kuptueshme dhe të aksesueshme për të rinjtë dhe personat e tjerë që përdorin hapësirën.

Rregullat bazë

Në këtë hapësirë:

- Çdo person trajtohet me respekt dhe dinjitet.
- Nuk tolerohen diskriminimi, ngacmimi, kërcënimi, dhuna, bullizmi ose sjellje të tjera që cenojnë sigurinë dhe mirëqenien e të tjerëve.
- Respektohen privatësia, dinjiteti dhe të drejtat e të rinjve dhe të personave të tjerë që përdorin hapësirën.
- Pajisjet, materialet dhe ambientet përdoren me kujdes dhe sipas qëllimit për të cilin janë vendosur.
- Fotografimi, filmimi ose publikimi i materialeve që identifikojnë persona të tjerë kryhet në përputhje me kërkesat për privatësinë dhe mbrojtjen e të dhënave personale.
- Nuk lejohen sjellje që pengojnë, frikësojnë ose përjashtojnë persona të tjerë nga përdorimi i hapësirës.
- Çdo person mund të kërkojë ndihmë ose të raportojë një shqetësim në mënyrën e përcaktuar nga institucioni.
- Shqetësimet trajtohen në mënyrë të respektueshme, të përshtatshme dhe në përputhje me përgjegjësitë institucionale dhe legjislacionin në fuqi.
- Rregullat zbatohen në mënyrë të drejtë dhe pa diskriminim.
- Të rinjtë mund të japin sugjerime dhe të propozojnë përmirësime lidhur me funksionimin dhe sigurinë e hapësirës.
- Në rast emergjence ose rreziku të menjëhershëm, ndiqen udhëzimet dhe procedurat e përcaktuara nga institucioni.

Ku mund të raportoj një shqetësim?

Nëse ndihesh i/e pasigurt, përjeton ose dëshmon një situatë shqetësuese, ose ke nevojë për ndihmë, mund t'i drejtohesh:

Personi/struktura përgjegjëse:

Kontakti:

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels
(EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)
Funded by the European Union

Mënyra e raportimit:

Orari/kohëzgjatja e disponueshmërisë:

Mundësi të tjera raportimi:

Çfarë duhet të dijë përdoruesi i hapësirës?

Institucioni duhet të përcaktojë dhe të bëjë të qartë:

- kujt mund t'i drejtohet i riu për ndihmë;
- si mund të bëhet një raportim;
- nëse dhe kur mund të përdoren mënyra konfidenciale të raportimit;
- çfarë ndodh pas marrjes së një shqetësimi;
- kur një çështje duhet t'i referohet një strukture ose shërbimi tjetër kompetent;
- cilat janë kontaktet që duhet të përdoren në raste emergjente.

Informacion tjetër i rëndësishëm:

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels
(EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)
Funded by the European Union

ANEKSI NR. 8 "TABELË ORIENTUESE PËR STAFIN DHE PERSONAT PËRGJEGJËS PËR NJË HAPËSIRË TË SIGURT PËR TË RINJTË"

Ky model mund të përshtatet sipas natyrës, funksionit, madhësisë, përdoruesve dhe nivelit të rrezikut të hapësirës.

Nr.	Fusha	Çfarë duhet të sigurojë institucioni	Çfarë duhet të ketë / të dijë / të bëjë stafi ose personi përgjegjës	Po	Pjesërisht	Jo	Masë/veprim i nevojshëm
1	Përgjegjësitë	Të përcaktohen qartë përgjegjësitë për administrimin, funksionimin dhe sigurinë e hapësirës.	Të njohë rolin dhe përgjegjësitë e veta dhe personat/strukturat ku duhet të drejtohet për çështje që tejkalojnë rolin e tij.				
2	Prania e stafit	Të përcaktohet prania ose disponueshmëria e stafit në përputhje me funksionin dhe orarin e hapësirës.	Të jetë i pranishëm ose i disponueshëm në përputhje me organizimin, funksionin dhe orarin e hapësirës.				
3	Marrëdhënia me të rinjtë	Të krijohet një mjedis ku të rinjtë trajtohen me respekt dhe dinjitet.	Të komunikojë në mënyrë të respektueshme, gjithëpërfshirëse dhe jo paragjykuese.				
4	Mbrojtja nga dhuna dhe abuzimi	Të ekzistojnë masa për parandalimin, identifikimin dhe trajtimin e situatave që cenojnë sigurinë ose mirëqenien.	Të njohë shenjat e një situate shqetësuese dhe mënyrën e duhur të raportimit ose referimit.				
5	Ngacmimi dhe bullizmi	Të ketë rregulla të qarta për parandalimin dhe trajtimin e ngacmimit, bullizmit dhe sjelljeve kërcënuese.	Të identifikojë situatat problematike dhe të zbatojë procedurat përkatëse.				
6	Mosdiskriminimi	Të sigurohet trajtim i barabartë dhe mundësi pjesëmarrjeje për të gjithë të rinjtë.	Të shmangë sjelljet diskriminuese dhe të identifikojë situata që mund të çojnë në përjashtim.				
7	Përfshirja dhe aksesueshmëria	Të merren parasysh nevojat e ndryshme dhe pengesat që mund të kufizojnë pjesëmarrjen.	Të njohë nevojat e ndryshme të përdoruesve dhe të kërkojë ose zbatojë përshtatjet e nevojshme.				
8	Komunikimi dhe informimi	Të rinjtë të kenë informacion të qartë se kujt mund t'i drejtohen për ndihmë.	Të jetë në gjendje të shpjegojë rregullat, mënyrat e raportimit dhe mundësitë për mbështetje.				
9	Raportimi	Të përcaktohet personi ose struktura ku mund të raportohen shqetësimet.	Të dijë si të marrë një raportim, kujt duhet t'ia përcjellë dhe cilat janë hapat e mëtejshëm.				
10	Referimi	Të identifikohen strukturat ose shërbimet kompetente për rastet që kërkojnë mbështetje të specializuar.	Të njohë mekanizmat bazë të referimit dhe kufijtë e rolit të vet.				

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels
(EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)

Funded by the European Union

11	Privatësia dhe të dhënat personale	Të zbatohen masa për mbrojtjen e privatësisë dhe të të dhënave personale.	Të dijë si të trajtojë informacionin personal, të respektojë kërkesat për mbrojtjen e të dhënave dhe të njohë kufijtë e konfidencialitetit, përfshirë rastet kur informacioni duhet të ndahet ose raportohet në përputhje me ligjin dhe procedurat përkatëse.				
12	Siguria digjitale	Të përcaktohen rregulla për përdorimin e pajisjeve, platformave dhe kanaleve digjitale.	Të njohë rreziqet kryesore digjitale dhe të përdorë në mënyrë të përgjegjshme kanalet e komunikimit.				
13	Emergjencat	Të përcaktohen përgjegjësitë dhe procedurat bazë për situatat emergjente.	Të njohë procedurat, daljet e emergjencës, pikat e grumbullimit dhe mënyrën e kërkimit të ndihmës.				
14	Aktivitetet jashtë hapësirës	Të përcaktohen masat e sigurisë dhe përgjegjësitë për aktivitetet jashtë hapësirës.	Të marrë parasysh rreziqet që lidhen me vendndodhjen, transportin, pjesëmarrësit dhe situatat emergjente.				
15	Pjesëmarrja e të rinjve	Të krijohen mundësi që të rinjtë të japin mendime për sigurinë dhe funksionimin e hapësirës.	Të dëgjojë dhe të pasqyroj mendimet dhe shqetësimet e të rinjve.				
16	Trajnimi dhe orientimi	Të identifikohen dhe adresohen nevojat e stafit për trajnim dhe orientim.	Të ketë njohuri dhe aftësi të përshtatshme për rolin dhe përgjegjësitë që ushtron.				
17	Kufijtë profesionalë	Të përcaktohen standarde të përshtatshme të sjelljes profesionale.	Të ruajë kufij të përshtatshëm profesionalë dhe të mos abuzojë me pozicionin ose përgjegjësinë e vet.				
18	Siguria dhe mirëqenia e stafit	Të marrë në analizë sigurinë dhe mirëqenien e stafit, vullnetarëve dhe personave të tjerë të angazhuar, veçanërisht gjatë situatave konfliktuale, incidenteve ose emergjencave.	Të njohë masat dhe procedurat për menaxhimin e situatave të vështira, të dijë kur duhet të kërkojë mbështetje dhe të përdorë mekanizmat përkatës të raportimit dhe referimit.				
19	Monitorimi dhe përmirësimi	Të monitorohet nëse masat e sigurisë dhe kapacitetet e stafit funksionojnë në praktikë.	Të marrë pjesë në identifikimin e problemeve dhe në përmirësimin e mënyrës së funksionimit të hapësirës.				

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels
(EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)
Funded by the European Union

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels
(EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)

Funded by the European Union

REFERENCAT LIGJORE DHE BIBLIOGRAFIA

A. Kuadri ligjor dhe standardet evropiane e ndërkombëtare:

- Konventa e Kombeve të Bashkuara "Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara";
- Rregullorja e Bashkimit Evropian 2016/679 "Për mbrojtjen e të dhënave personale";
- Strategjia e Bashkimit Evropian për Rininë 2019–2027;
- Objektivat Evropiane për Rininë (European Youth Goals);
- Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian;
- Strategjia e Bashkimit Evropian për të Drejtat e Fëmijës;
- Strategjia e Këshillit të Evropës për të Drejtat e Fëmijës 2022–2027;
- Konventa e Këshillit të Evropës "Për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual" - Konventa e Lanzarotës;
- Këshilli i Evropës, Rekomandimi CM/Rec(2017)4 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare "Mbi punën me të rinjtë";
- Rekomandimi CM/Rec(2016)7 "Mbi aksesin e të rinjve në të drejtat e tyre";
- Rekomandimi CM/Rec(2015)3 "Mbi aksesin e të rinjve nga zonat me akses të kufizuar në të drejtat sociale";
- Këshilli i Evropës, Karta Evropiane e Rishikuar për Pjesëmarrjen e të Rinjve në Jetën Vendore dhe Rajonale, 2015;
- Këshilli i Evropës, Çështjet gjinore: Manual për trajtimin e dhunës me bazë gjinore që prek të rinjtë;
- Këshilli i Evropës, Etiketa e Cilësisë për Qendrat Rinore – Roli, Vlera dhe Ndikimi;

B. Legjislacioni shqiptar:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, (e ndryshuar);
- Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", (i ndryshuar);
- Ligji nr. 93/2014, datë 24.07.2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara", (i ndryshuar);
- Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", (i ndryshuar);
- Ligji nr. 121/2016, "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", (i ndryshuar);
- Ligji nr. 18/2017, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", (i ndryshuar);
- Ligji nr. 111/2017, "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti";
- Ligji nr. 75/2019, datë 04.11.2019 "Për rininë", (i ndryshuar);
- Ligji nr. 124/2024, "Për mbrojtjen e të dhënave personale";
- Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022–2029;
- Plani i Veprimit për zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022–2029;
- Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023–2030;
- Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore.

Support Albanian youth civic participation, community engagement and volunteerism, through promoting inclusive, gender responsive and structured dialogue and strengthening youth capacities at the central and local levels
(EC-NEAR/TIA/2024/EA-RP/0084)
Funded by the European Union